EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5722
E hënë, 11 mars 2019
çmimi 0.40 €

Gërxhaliu: Është koha të rishikohet marrëveshja e CEFTA-s

FAQE 7

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", VALON MURTEZAJ FAQE 4-5

MOSUNITETI DOBËSON POZITËN E KOSOVËS NË DIALOGUN ME SERBINË

Profesori universitar i negocimit ndërkombëtar në Paris, Valon Murtezaj, ka thënë se pa konsensus nacional pozita e Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë do të jetë më e dobët. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se përfundimisht duhet ta kuptojë i gjithë spektri politik në vend se kur është në pyetje interesi nacional, uniteti është çështje e domosdoshme. Ish-zëvendës-ministri i Punëve të Jashtme ka shpre-hur optimizëm se shumë shpejt do të gjendet një alternativë për daljen e vendit nga situata aktuale politike. "Nëse nuk tejkalohet nyja e krijuar, atëherë zgjedhjet e reja apo qeveria gjithëpërfshirëse me përfaqësim fer dhe të drejtë, sipas fuqisë politike të forcave politike, mbetet opsioni tjetër", ka thënë Murtezaj

SYLA: 'TREPÇA' U REGJISTRUA ME TË GJITHA NJËSITË DHE ASETET SIPAS LIGJIT DHE STATUTIT

Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës në "Trepçë", Ardian Syla, ka thënë se kjo ndërmarrje është regjistruar si shoqëri aksionare me të gjitha asetetet dhe njësitë biznesore në tërë territorin e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se njësitë biznesore dhe asetet siç janë minierat me flotacion kopaonik, metalurgjia e plumbit, laboratori në Zveçan, kompleksi administrativ në Zveçan janë të përfshira në certifikatën e biznesit të "Trepça" sh. a. Syla ka bërë me dije se tani do ta fillojnë fazën e dytë të kompletimit të listës së aksionarëve në njësitë e tjera

Opozita synon t'i sigurojë 61 vota për rrëzimin e qeverisë

FAQE 3

AKTUALE

PËRVEÇ HEQJES SË TAKSËS, SERBIA VË KUSHT HEQJEN E PLATFORMËS SË KOSOVËS PËR VAZHDIMIN E DIALOGUT

F. 11

Bardhyl MAHMUTI

A PO SHTROHET RRUGA PËR PËRFSHIRJEN E DREJTPËRDREJTË TË SHBA-së NË DIALOG?

F. 2

LEGALIZIMI I ARMËVE PA LEJE, I NGADALSHËM NË KOSOVË

F. 6

TAHIRI: 11, 15 OSE 17 MINISTRI PARASHIHEN NË LIGJIN PËR QEVERINË

F. 7

EKONOMI

BQK-ja: BORXHI PUBLIK I KOSOVËS KA ARRITUR NË 1.1 MILIARD EURO

F. 8

SPORT

FITOJNË FAVORITET PËR TITULL

F. 14

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Vuçiqi: Taksa dhe platforma nuk bëjnë zgjidhje, shkaktojnë probleme

Beograd, 10 mars - Në Patrikanën e Beogradit presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kryeministrja Ana Brnabiq dhe ministri i Punëve të Jashtme, Ivica Daçiq, janë takuar me kreun e Kishës Ortodokse të Serbisë, patriarkun Irinej dhe me anëtarët e Sinodit të KOS-it.
Pas këtij takimi, Vuçiqi ka thënë se Serbia ndodhet në një situatë të vështirë përballë Kosovës. "I jam mirënjohës patriarkut dhe anëtarëve të Sinodit të Kishës Ortodokse Serbe, të cilët kishin vullnet të më dëgjojnë. Ne i sollëm patriarkut dhe të tjerëve tekstin e Platformës të cilën shqiptarët e Kosovës e kanë miratuar për qëllime të ndërprerjes së dialogut me Beogradin dhe i kanë informuar me të gjitha veprimet që i kanë bërë nga moszbatimi i marrëveshjes së Brukselit, pastaj taksës, deri te platforma, e cila, në fakt, është tregues se sa disa njerëz duan të shkaktojnë krizë dhe probleme, e jo zgjidhjen e problemit", ka thënë Vuçiqi.

A po shtrohet rruga për përfshirjen e drejtpërdrejtë të ShBA-së në dialog?

Të shtunën ka qëndruar për vizitë në Prishtinë nënsekretari amerikan për Çështje Politike, David Hale, i cili ka zhvilluar një takim me udhëheqësit e institucioneve të Kosovës, Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe Ramush Haradinajn, ku temë diskutimi ka qenë procesi i dialogut Kosovë - Serbi. Profesori universitar Valon Murati ka theksuar se nuk janë të rastësishme vizitat e zyrtarëve të lartë amerikanë në Prishtinë, deklarimet e tyre për domosdoshmërinë e një marrëveshjeje në mes të Kosovës dhe Serbisë

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

Prishtinë, 10 mars - Profesori universitar, njëherësh kryetar i Lëvizës për Bashkim (LB), Valon Murati, përmes një shkrimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se "po shtrohet rruga për përfshirjen e drejtpërdrejtë të ShBA-së në dialog". Ai ka bërë me dije se nuk janë të rastësishme vizitat e zyrtarëve të lartë amerikanë në Prishtinë dhe Beograd. "Dobësimi i brendshëm i BE-së, destruktiviteti i vazhdueshëm i Beogradit, vendosja e taksës nga ana e Kosovës si masë reciprociteti dhe platforma për bisedime po çojnë drejt kolapsit të bisedimeve në formatin e tanishëm. Dialogut të tejzgjatur a pa farë rezultati konkret të Brukselit, ku është folur vetëm për Kosovën dhe pozitën e serbëve në të, si duket po i vjen fundi. Të gjitha indikacionet janë se po krijohen kushtet që ShBA-ja ose të përfshihet më aktivisht, ose ta marrë rolin prijës në procesin e dialogut Kosovë - Serbi", ka thënë Murati. Sipas tij, interesimi i amerikanëve për arritjen e marrëveshjes përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të shihet edhe si përpjekje amerikane për ta ndalur depërtimin rus në Ballkan. "Nuk janë të rastësishme vizitat e zyrtarëve të lartë amerikanë në Prishtinë, deklarimet e tyre për domosdoshmërinë e një marrëveshjeje në mes të Kosovës dhe Serbisë e deri te përfshirja përmes letrave e deklaratave edhe e presidentit Tramp, e sekretarit të Shtetit Pompej. Kjo përfshirje e amerikanëve dhe zgjidhjet që mund të vijnë, duhen shikuar edhe nën prizmin e përpjekjeve amerikane për ta ndalur depërtimin çdoherë e më të hapur të interesave ruse në rajonin e Ballkanit", ka thënë Murati.
Nënsekretari amerikan për Çështje Politike, David Hale, të shtunën ka vizituar Kosovën, ku ka zhvilluar takime me udhëheqësit e institucioneve të Kosovës. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj dhe kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, në prani të ambasadorit amerikan Philip Kosnett, kanë zhvilluar një takim në rezidencën amerikane në mëngjesin e së shtunës me nënsekretarin David Hale. Pas takimit, liderët nuk kanë pranuar të flasin para medieve. Përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", presidenti i Kosovës ka thënë se në këtë takim është diskutuar për dialogun me Serbinë dhe se Kosova përsëriti zotimin se është gati për dialog sa më gjithëpërfshirës dhe transparent. "Për këtë edhe Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Platformën për Dialogun", ka shkruar Thaçi.
Presidenti ka treguar se kanë biseduar edhe për zhvillimet aktuale në Ballkanin Perëndimor, me theks të veçantë për vazhdimin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë në këtë momentum të ri, si mundësi për një marrëveshje përfundimtare dhe gjithëpërfshirëse, që do t'i mbyllë të gjitha çështjet e hapura në mes të vendeve tona. "Pra, për një marrëveshje ligjërisht obliguese, që do ta sjellë njohjen reciproke dhe ulësen në Kombet e Bashkuara dhe që do të na mundësojë që të kalojmë nga gjendja e armiqësisë së përhershme, në një gjendje të paqes, normalitetit dhe bashkëpunimit mes vendeve tona", ka thënë Thaçi .
Ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, përmes një postimi në "Twitter" ka shkruar se nënsekretari Hale ka vlerësuar qëndrimet e liderëve të Kosovës dhe ka nënvizuar përkushtimin e ShBA-së për Kosovën dhe rajonin.
Edhe kryeministri Ramush Haradinaj përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka treguar se ka ritheksuar qëndrimin e Kosovës për rikthimin e dialogut me Serbinë ku do të diskutohen të gjitha çështjet, përfshirë edhe tregtinë e lirë që të arrihet marrëveshje me njohje në kufijtë ekzistues.
Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka bërë me dije se në këtë takim ka theksuar se qëllimet e Kosovës mund të arrihen vetëm duke ruajtur dhe duke fuqizuar partneritetin e përjetshëm ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së. "Po ashtu, z. Hale i shpreha qëndrimin tim të vendosur që për asnjë arsye nuk do të lejoj rrezikimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe ShBA-ve dhe se veprimet tona të ardhshme do të jenë të koordinuara me ShBA-në", ka thënë Veseli.
Koalicioni qeverisës në Kosovë nuk po arrin të gjejë ndonjë zgjidhje për ta përmbushur kërkesën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian për pezullimin e tarifës doganore si hap i domosdoshëm për vazhdimin e dialogut me Serbinë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës presin që Kosova dhe Serbia ta arrijnë marrëveshjen gjithëpërfshirëse brenda vitit 2019, e cila do të përfundojë me njohje reciproke.

Basha: Protesta e 16 marsit, takim me historinë

Tiranë, 10 mars - Pas një periudhe të gjatë mungese, kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, i është bashkuar të dielën pasdite protestës së banorëve të "Astirit". Basha iu është drejtuar banorëve se ka ardhur koha që vendimet t'i marrin vetë ata, ndërsa i ka ftuar t'i bashkohen protestës së 16 marsit. Ai tha se kryeministri Edi Rama nuk mund të vendosë më për askënd në vend, pasi konsiderohet "i paligjshëm". "Edi Rama, ti nuk merr dot asnjë vendim për shqiptarët. Je i paligjshëm, je ilegjitim. Je po aq ilegjitim dhe i paligjshëm si kriminelët me të cilët ke marrë pushtetin. Sot nga unaza kam një mesazh për çdo qytetar: ka ardhur koha që vendimet t'i merrni ju. Ju duhet të vendosni siç keni vendosur të nisim së bashku një rrugëtim që na bën bashkë më të vendosur drejt vlerave evropiane dhe drejt Shqipërisë evropiane", tha ai.
Sa i takon djegies së mandateve, Basha ka thënë se është vendimi i drejtë, i ligjshëm, patriotik dhe demokratik. "Djegia e mandateve të opozitës është vendimi më i ligjshëm, demokratik dhe patriotik i ndërmarrë ndonjëherë. Me këtë vendim ne dolëm në krah të popullit, jashtë nga parlamenti i krimit. Me këtë vendim ne kemi marrë një hap historik për t'i dhënë fund një regjimi të kalbur. Ky është vendimi që ne kemi marrë. Është vendim i drejtë, është vendimi për të mos qëndruar krah kriminelëve, por për të qëndruar në krahë të qytetarëve dhe shqiptarëve", tha ai. Basha e konsideroi protestën e 16 marsit një takim me historinë dhe triumf i shqiptarëve të bashkuar.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Partitë opozitare po bëjnë përpjekje për ta rrëzuar qeverinë, pozita synon ta çojë deri në fund mandatin qeverisës

Opozita synon t'i sigurojë 61 vota për rrëzimin e qeverisë

Dy partitë opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV), janë duke bërë përpjekje t'i sigurojnë votat e nevojshme për rrëzimin e Qeverisë Haradinaj. Opozitarët kanë thënë se ky proces nuk do të jetë i lehtë edhe pse, sipas tyre, ekzistojnë 100 arsye pse duhet rrëzuar qeveria. Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, dhe deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi, kanë bërë me dije se opozita do ta procedojë mocionin ndaj qeverisë sapo t'i sigurojnë 61 vota. Por, deklaratave për rrëzimin e qeverisë iu është kundërpërgjigjur nënkryetari i AAK-së, Pal Lekaj, i cili ka thënë se Qeveria Haradinaj do ta çojë deri në fund mandatin qeverisës

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 10 MARS - Përfaqësuesit e dy subjekteve opozitare, Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Lëvizjes Vetëvendosje (LV), të dielën kanë bërë me dije se janë duke punuar për t'i siguruar 61 vota të deputetëve të Kuvendit të Kosovës për rrëzimin e qeverisë. Megjithatë, ata kanë vlerësuar se ky proces nuk do të jetë i lehtë ani pse, sipas tyre, ekzistojnë 100 arsye pse duhet rrëzuar Qeveria Haradinaj.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Ismajl Kurteshi, ka thënë të dielën për gazetën "Epoka e re" se kjo parti e ka seriozisht synimin për rrëzimin e qeverisë aktuale mirëpo, sipas tij, deri më tani partitë opozitare nuk kanë arritur t'i sigurojnë 61 vota për ta bërë një gjë të tillë. "Opozita e ka këtë detyrë dhe përherë e ka seriozisht rrëzimin e qeverisë si dhe ardhjen në pushtet. Por, natyrisht për të ndodhë një gjë e tillë duhen numrat dhe, sa di unë, ende nuk i kemi numrat e nevojshëm, pra 61 sosh. Atë ditë që do t'i kemi numrat do ta kërkojmë mocionin e votëbesimit për ta rrëzuar Qeverinë Haradinaj. Sidoqoftë, përherë ka gjasa dhe nuk duhet humbur shpresën sepse jemi duke punuar në atë drejtim në mënyrë që sa më shpejt ta rrëzojmë këtë qeveri", ka deklaruar Kurteshi.

Mirëpo zyrtari i Lëvizjes Vetëvendosje ka treguar se kjo parti vetëm për çështjen e taksës nuk do ta rrëzonte Qeverinë Haradinaj. Sipas Kurteshit, vendosja e taksës ndaj produkteve serbe dhe boshnjake është hap i drejtë dhe qeveria e ka mbështetjen e plotë të Lëvizjes Vetëvendosje në këtë aspekt. "Janë 100 arsye pse duhet të rrëzohet qeveria aktuale, por vetëm për taksën ndaj Serbisë ne nuk e rrëzojmë qeverinë. Për taksë mendojmë se është shumë hap i drejtë dhe e përkrahim në këtë aspekt qeverinë", është shprehur Kurteshi.

Për rrëzimin e Qeverisë së Kosovës ka folur të dielën edhe shefi i Grupit Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti. Ai ka bërë me dije se LDK-ja do ta procedojë mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë Haradinaj në momentin që do t'i sigurojnë 61 vota të deputetëve të Kuvendit. "LDK-ja do të procedojë me mocion të votëbesimit ndaj Qeverisë së PAN-it në momentin që sigurohen 61 vota në Kuvendin e Kosovës, por nuk pranon asnjë kushtëzim nga askush", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Deklaratave për rrëzimin e qeverisë iu është kundërpërgjigjur nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj. Pavarësisht prej kërcënimeve të opozitës dhe të Listës Serbe, ai ka thënë se Qeveria Haradinaj do ta çojë deri në fund mandatin qeverisës. Sipas Lekajt, deputetët serbë duhet ta trajtojnë me seriozitet detyrën e deputetit dhe t'i lënë anash kërcënimet. "Nëse deputetët e Listës Serbe kanë vendosur ta presin seancën për rrëzimin e Qeverisë Haradinaj, atëherë pritja për ta do të zgjasë deri në përfundim të këtij mandati. Prandaj, u bëj thirrje ta trajtojnë me seriozitet detyrën e deputetit dhe t'i lënë anash kërcënimet", ka shkruar Lekaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ambasadorja e Finlandës: Taksa të hiqet, për liberalizimin e vizave ka ende punë

Prishtinë, 10 mars - Edhe Finlandës nuk po i pëlqen vendimi i Qeverisë së Kosovës i marrë më 21 nëntor të vitit të kaluar për vendosjen e takës prej 100 qindpërqindtësh ndaj produkteve që vijnë nga Serbia dhe Bosnja. Ambasadorja e Finlandës në Kosovë, Pia Stjernvall, ka thënë për "Ekonomia Online" se taksa nuk është vendim i duhur. Ajo ka thënë se Finlanda është pro tregut të lirë dhe kështu sugjeron të veprojë edhe Kosova për të mirën e përgjithshme.

Stjernvall ka theksuar se edhe reagimet kundër taksës janë me vend, por prapë insiston se tregu i lirë është i domosdoshëm për zhvillimin ekonomik të dy vendeve. Stjernvall ka thënë se çështja e liberalizimit të vizave nuk varet vetëm nga vendi që ajo vjen, por nga gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Madje përfaqësuesja e Finlandës thotë se ka ende punë për t'u bërë sa i përket lëvizjes së lirë të qytetarëve të Kosovës në Zonën Shengen.

Flet për "Epokën e re", Valon Murtezaj

Mosuniteti dobëson pozitën e Ko

Profesori universitar i negocimit ndërkombëtar në Paris, Valon Murtezaj, ka thënë se pa konsensus nacional pozita e Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë do të jetë më e dobët. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se përfundimisht duhet ta kuptojë i gjithë spektri politik në vend se kur është në pyetje interesi nacional, uniteti është çështje e domosdoshme. Ish-zëvendësministri i Punëve të Jashtme ka shprehur optimizëm se shumë shpejt do të gjendet një alternativë për daljen e vendit nga situata aktuale politike. "Nëse nuk tejkalohet nyja e krijuar, atëherë zgjedhjet e reja apo qeveria gjithëpërfshirëse me përfaqësim fer dhe të drejtë, sipas fuqisë politike të forcave politike, mbetet opsioni tjetër", ka thënë Murtezaj

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 10 MARS - Profesori universitar i negocimit ndërkombëtar në Paris, Valon Murtezaj, ka ftuar spektrin politik për unitet në çështjen e dialogut me Serbinë. Ai ka bërë me dije se pa unitet pozita e Republikës së Kosovë në këtë proces do të jetë më e dobët. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Murtezaj ka vlerësuar se edhe platforma për bisedime me Serbinë, e miratuar në Kuvend, nuk e ka peshën e saj pa votat e dy partive më të mëdha opozitare. "Një gjë duhet ta kuptojë i gjithë spektri politik përfundimisht, kur bëhet fjalë për interesat nacionale të Republikës së Kosovës, siç është rasti me dialogun me Serbinë, sa herë që nuk ka unitet në reprezentim, pozita e Kosovës në tavolina të bisedimeve dobësohet. Prandaj, platforma, përveç aspekteve të përplasjes me Kushtetutën që duhet konsultuar, pa votat e opozitës nuk e ka peshën e nevojshme që duhet ta ketë në këtë fazë", ka thënë Murtezaj.

Ish-zëvendësministri i Punëve të Jashtme në mandatin e kaluar qeverisës ka treguar se votimet me shumicë të thjeshtë nuk do të duhej të ishin praktikë në këto raste. Sipas tij, uniteti në këtë çështje ka të bëjë edhe me zbatimin e marrëveshjeve në të ardhmen. "Pa unitetin nacional të veprimit proceset e vështira negociatore nuk ecin përpara. Uniteti duhet të gjendet në kapacitetin për t'i tejkaluar egot protagoniste dhe duke u bazuar në kushtetutshmërinë e veprimeve", është shprehur ai. Murtezaj ka ftuar institucionet e Kosovës të jenë të kujdesshme sidomos në raportet me ShBA-në. Ai ka deklaruar se Kosova duhet të sillet si partnere serioze në marrëdhëniet e shkëlqyeshme dhe të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Tanimë u theksua qartë nga z. David Hale, se Shtetet e Bashkuara e përkrahin Kosovën dhe kështu do të vazhdojë. Natyrisht, Kosova

sovës në dialogun me Serbinë



duhet të sillet si partnere serioze në këtë marrëdhënie të shkëlqyer të përhershme me Shtetet e Bashkuara, ta marrë përgjegjësinë dhe ta ofrojë kontributin e vet me pjekuri maksimale", është shprehur Murtezaj.

Profesori universitar i negocimit ndërkombëtar në Paris ka shprehur optimizëm se zgjidhja për daljen nga kjo situatë do të vijë shumë shpejt. "Gjatë javëve në vijim kam besim që gjërat do të marrin rrjedhën e duhur për Kosovën, sepse kështu po humbet shumë kohë dhe ka stagnim. Nëse nuk tejkalohet nyja e krijuar atëherë zgjedhjet e reja, apo qeveria gjithëpërfshirëse, me përfaqësim fer dhe të drejtë sipas fuqisë politike të forcave politike, mbetet opsioni tjetër", ka thënë Murtezaj

"Epoka e re": *Z. Murtezaj, Kuvendi i Kosovës ka arritur ta miratojë ligjin dhe platformën për dialogun me Serbinë, por pa dy subjektet më të mëdha opozitare. Çfarë do të thotë kjo për Kosovën?*

Murtezaj: Një gjë duhet ta kuptojë i gjithë spektri politik përfundimisht, kur bëhet fjalë për interesat nacionale të Republikës së Kosovës, siç është rasti me dialogun me Serbinë, sa herë që nuk ka unitet në reprezentim, pozita e Kosovës në tavolina të bisedimeve dobësohet. Prandaj, platforma, përveç aspekteve të përplasjes me Kushtetutën që duhet konsultuar, pa votat e opozitës nuk e ka peshën e nevojshme që duhet ta ketë në këtë fazë.

"Epoka e re": *Shumëkush vlerëson se një proces kaq i rëndësishëm për Kosovën, siç është dialogu me Serbinë, nuk mund të zhvillohet pa opozitën. Si duhet të arrihet deri te një konsensus nacional për këtë çështje?*

Murtezaj: Ashtu është, sepse po flasim për një proces që ka të bëjë me aspekte të rëndësisë supreme për Kosovën dhe shtetësinë e saj. Votimet me shumicë të thjeshtë nuk do të duhej të ishin praktikë në raste të këtilla. Për shkak se ndërmjetësuesit ndërkombëtarë nuk janë të bindur në përfaqësim adekuat dhe, po ashtu, kjo lidhet me zbatimin e marrëveshjeve në të ardhmen. Pa unitetin nacional të veprimit, proceset e vështira negociatore nuk ecin përpara. Uniteti duhet të gjendet në kapacitetin për t'i tejkaluar egot protagoniste dhe duke u bazuar në kushtetut-shmërinë e veprimeve.

"Epoka e re": *Sipas asaj që po shohim, ky proces nuk mund të fillojë pa ndodhur pezullimi i taksës ndaj mallrave serbe. Thirrjet për suspendim të kësaj takse janë të vazhdueshme nga zyrtarët më të lartë amerikanë. Çfarë duhet të bëjnë institucionet e Kosovës për të dalë nga kjo situatë?*

Murtezaj: Besoj se tani kemi hyrë në një fazë të konsultimeve intensive me partnerët kryesorë të Kosovës. Vizitat intensive në javët e fundit nga Shtetet e Bashkuara, si partner kryesor i Kosovës, si dhe takimet më të deleguar nga Gjermania këtë javë dhe Britania e Madhe, do të ofrojnë një mundësi të mirë për të krijuar një potencial të mirë për ta tejkaluar nyjën e krijuar dhe për të ecur përpara. Kjo ka të bëjë me tarifën, me procesin e dialogut në përgjithësi, por dhe me qasjen e gjithëmbarshme ndaj proceseve. Qeveria e Serbisë po tregohet destruktive si në sjellje, po ashtu edhe në retorikë. Dhe, kjo duhet të merret parasysh në gjithë diskutimet që po ngjajnë.

"Epoka e re": *Mosrespektimi i kështillës amerikane për suspendim të taksës a mund të ndikojë në ftohjen e raporteve Kosovë - ShBA?*

Murtezaj: Tanimë u theksua qartë nga z. David Hale, se Shtetet e Bashkuara e përkrahin Kosovën dhe kështu do të vazhdojë. Natyrisht, Kosova duhet të sillet si partnere serioze në këtë marrëdhënie të shkëlqyer të përhershme me Shtetet e Bashkuara, ta marrë përgjegjësinë dhe ta ofrojë kontributin e vet me pjekuri maksimale.

"Epoka e re": *Si opsione për daljen nga situata aktuale janë përmendur zgjedhjet e reja ose qeveria gjithëpërfshirëse. Cila do të ishte alternativa më e mirë për Kosovën?*

Murtezaj: Gjatë javëve në vijim kam besim se gjërat do ta marrin rrjedhën e duhur për Kosovën, sepse kështu po humbet shumë kohë dhe ka ngecje. Nëse nuk tejkalohet nyja e krijuar, atëherë zgjedhjet e reja apo qeveria gjithëpërfshirëse me përfaqësim fer dhe të drejtë sipas fuqisë politike të forcave politike mbetet opsioni tjetër.

Pacolli: Vuçiqi duhet të kthehet në tavolinën e dialogut

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 10 MARS - Ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, i ka bërë thirrje presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, që mos ta luajë rolin e molerit në lojën Lindje - Perëndim, por të kthehet në tavolinë të dialogut.

Pacolli përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se Serbia nuk duhet të luhatet në lojën e saj mes Lindjes dhe Perëndimit, por duhet të ketë një platformë për bisedimet e ardhshme. "Presidenti i Serbisë, Vuçiq, duhet ta kuptojë se Serbia nuk mund të bëhet pykë në marrëdhëniet strategjike dhe të përhershme mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës së Kosovës dhe duhet të ndalet retorika agresive ndaj Kosovës. Zotëri Vuçiqi e di fare mirë se në bisedime shkohet me platformë të qartë. Serbia nuk duhet të luhatet e kurthuruar në lojën e saj mes Lindjes dhe Perëndimit, por duhet të ketë një platformë për bisedimet e ardhshme. E siguroj Vuçiqin që asnjë paqe e qëndrueshme dhe afatgjatë nuk mund të ndërtohet pa gjykimin e krimeve, prandaj në funksion të kësaj duhet të ketë një gjykatë e cila do të merrej me përgjegjësinë kriminale të Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës", ka thënë Pacolli, duke shtuar se rajoni duhet të pastrohet nga krimi dhe kriminelët që shëtisin të lirë gjithandej në Serbi dhe rajon. "Në anën tjetër, presidenti Vuciq nuk ka pse të brengoset për komunitetin serb që jeton në Kosovë, sepse nuk ka komunitet në botë që gëzon të drejta dhe siguri në nivelin që kanë qytetarët serbë në Republikën e Kosovës. E për 'gëlqerosje'…, si theksoi ai, e ftoj që mos ta luaj rolin e molerit në lojën Lindje - Perëndim, por të kthehet në tavolinë të dialogut ku po ju presim me platformë", ka thënë Pacolli.

Ndaj deklaratave të fundit të presidentit serb ka reaguar edhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, i cili ka thënë se presidenti serb, Aleksandër Vuciq, me retorikë luftënxitëse, si ish-shefi i tij Millosheviqi, është duke i frikësuar qytetarët serbë dhe fajësuar gjithë botën. Sipas tij, në këtë drejtim Vuçiqi, si duket, po përgatitet ta destabilizojë rajonin, gjithmonë duke i përdorur qytetarët serbë të Kosovës, të cilët janë në presion për t'u shërbyer qëllimeve të tij politike. "Me paralajmërimet e vazhdueshme, se do të marrë masa duke përcaktuar afate kohore, tregon se ai po tenton t'i përdorë edhe këtë herë serbët e Kosovës për interesa të veta. Në fakt, kjo është shkolla e Millosheviqit, që Vuçiqi, me shumë përkushtim, po mundohet ta imitojë ish-shefin e vet në çdo gjë. Shtirja e tij e alarmuar për platformën tregon më së miri se sa larg është ai nga realiteti. Kosova pas tre muajve mbush 20 vjet që është e lirë. Ndërsa para rreth një muaji festuam 11-vjetorin e Pavarësisë", ka thënë Limaj, duke shtuar se në platformën që ka miratuar Kuvendi i Kosovës nuk ka asgjë tjetër përveç përshkrimit të këtij realiteti që sot ekziston. "Porosia ime për të është ta pranojë realitetin e krijuar tash e dy dekada në këtë pjesë të Ballkanit", ka thënë zëvendëskryeministri Limaj.

Legalizimi i armëve pa leje, i ngadalshëm në Kosovë

Pas një fillimi të zbehtë, fushata për legalizimin e armëve të vogla dhe të lehta ka nisur të japë pak më shumë rezultate muajt e fundit. Kështu kanë thënë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP)

Prishtinë, 10 mars - Nën moton "Me letra", fushata, e cila ka nisur në fund të vitit 2018 në një afat kohor prej gjashtë muajve, ka për qëllim t'i bindë qytetarët t'i përgjigjen thirrjes për legalizimin e armëve pa leje të cilat i kanë.

Destan Mustafa, udhëheqës i Divizionit për Armë, Municion dhe Eksploziv në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se në fillim të kësaj fushate vetëdijesimi dhe interesimi i qytetarëve ishte i ulët. Ndërsa që nga muaji janar, sipas tij, interesimi për legalizim të armëve është shtuar. "Ne kemi parë që në fillimi ishte një vetëdijesim i vogël. Prej janarit e deri më sot çdoherë ka ngritje të besimit. Ne edhe tani kemi filluar të lëshojmë disa pëlqime. Është ngritur edhe më shumë besimi i qytetarëve se shteti në këtë rast nuk e ka qëllimin t'i mbledhë armët, siç kanë qenë disa propaganda. Kjo nuk është aspak e vërtetë. Besojmë se është rritur dhe e vërejmë dita-ditës që është ngritur dëshira e qytetarëve për legalizim", ka thënë Mustafa.

Edhe Marta Gazideda, menaxhere në sektorin e ndërtimit të Paqes në UNDP, në një përgjigje nëpërmjet postës elektronike për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se lansimi i kësaj fushate po del të jetë mjaft i suksesshëm. Sipas Gazidedës, 420 persona kanë aplikuar për legalizimin e armëve të tyre. Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka rreth 260 mijë armë ilegale që janë në posedim të qytetarëve. Kurse afër 50 mijë llogaritet të jetë numri i përgjithshëm i armëve legale, prej të cilave 22 mijë janë me leje të Republikës së Kosovës, ndërsa 25 mijë armë të tjera që kanë pasur leje nga ish-administrata e UNMIK-ut po i nënshtrohen procesit të legalizimit.

Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës dhe njohësi i çështjeve të sigurisë, Nuredin Ibishi, ka thënë se iniciativa apo fushata aktuale ka treguar pak sukses. Sipas tij, faji mund të jetë edhe te procedurat, të cilat janë tejet gjata për legalizimin e një arme. "Prej momentit kur bëhet paraqitja e armës e deri te marrja e lejes, pasi që është në kuadër të kritereve të përcaktuara për legalizim apo armëmbajtje, është shumë e koklavitur në kuptimin që është e ngarkuar procedura. Tjetra është se taksat vazhdojnë të jenë relativisht të mëdha, edhe të trajnimeve, edhe të certifikimit për armëmbajtje e deri te certifikata mjekësore që relativisht e kanë një kosto të lartë", ka vlerësuar Ibishi.

Rreziku nga armët pa leje, nënvizon Ibishi, është evident, marrë parasysh edhe faktin se shumë krime dhe vepra penale që po ndodhin në Kosovë kanë dëshmuar se janë kryer me armët ilegale që janë në duart e qytetarëve. "Rreziku është permanent për armëmbajtjen ilegale, në kuptim të asaj se të gjitha këto vepra penale të cilat po kryhen, edhe vrasjet, edhe grabitjet, janë nga persona që kanë armë ilegale", ka bërë me dije Ibishi.

Në anën tjetër, sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, në dymujorin e vitit 2019 janë konfiskuar 236 armë dhe 3114 municione të kalibrave të ndryshme. Kostoja totale për legalizim, përfshirë kontrollet shëndetësore, vërtetimet, trajnimin dhe lejen, arrin vlerën e rreth 300 eurove.

Gjatë kohës sa zgjat fushata për legalizimin e armëve pa leje, me vendim të ministrit të këtij dikasteri, Ekrem Mustafa, është pezulluar zbatimi i nenit 374 të Kodit Penal, i cili, në paragrafin një, parasheh gjobë deri në 7 500 euro ose dënim me burgim deri në pesë vjet për armëmbajtje pa leje. Aty parashihet edhe dënim dy deri në dhjetë vjet burgim për posedim ilegal të katër ose më shumë armëve ose më shumë se 400 fishekëve.

OVLUÇK-ja: Graham William Phillips punon për interesat ruse

Prishtinë, 10 mars (ER) - Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) ka reaguar ndaj veprimeve të Graham William Phillips, duke thënë se luftën e UÇK-së nuk mund ta njollosë askush.

Nëpërmjet një deklarate për medie OVLUÇK-ja ka thënë se i vetëshpalluri gazetar ushtarak britanik ka punuar dhe punon për interesat ruse. "Organizata e Veteranëve të Luftës nuk është e habitur me Graham William Phillips, i njohur për skandale të mëhershme, të vetëshpallurin gazetar ushtarak britanik, për shkak se ai ka punuar dhe punon për interesat ruse. Të gjithë e dimë se edhe më herët janë bërë shumë akuza ndaj UÇK-së si nga Del Ponte e më vonë nga Dick Marti e raporte të tjera, por luftën e saj nuk do të mund ta njollosin", është thënë në reagimin e OVLUÇK-së.

Gërxhaliu: Është koha të rishikohet marrëveshja e CEFTA-s

Sekretari i përgjithshëm në Forumin Investiv të Odave të Ballkanit Perëndimor WB6 me seli në Itali, Safet Gërxhaliu, ka thënë se tani është momenti i duhur të kërkohet shqyrtimi dhe negocimi i marrëveshjes së CEFTA-s. Ai ka theksuar se kjo marrëveshje ka pasur sfida të cilat kanë ndikuar që Kosova të jetë e anashkaluar, e dëmtuar dhe e nënçmuar

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 10 MARS - Sekretari i përgjithshëm në Forumin Investiv të Odave të Ballkanit Perëndimor WB6 me seli në Itali, Safet Gërxhaliu, ka thënë se tani është koha kur Kosova duhet ta rishikojë marrëveshjen e CEFTA-s duke marrë parasysh dëmet që janë shkaktuar nga kjo marrëveshje. Kosova u bë anëtare fuqiplotë e CEFTA-s në korrik të vitit 2007, tetë muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes për anëtarësim. Marrëveshja në atë kohë është nënshkruar nga UNMIK-u në emër të Kosovës.

Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se rishikimin e marrëveshjes së CEFTA-s janë duke e kërkuar edhe vendet e regjionit pasi, sipas tij, ekzistojnë një mori barrierash në mes të vendeve të Ballkanit Perëndimor. "Kohët e fundit është duke u diskutuar shumë rreth marrëveshjes së CEFTA-s dhe funksionimit të saj, si dhe sfidat me të cilat po ballafaqohet komunitet i prodhuesve vendorë. Andaj është momenti kur Kosova duhet të përgatitet për rishikimin e kësaj marrëveshje me qëllim që të jemi në funksion të lëvizjes së lirë të mallrave dhe të shërbimeve. Një kërkesë e tillë është duke u aktualizuar shumë edhe sa i përket arenës ndërkombëtare dhe regjionale. Kohët e fundit kishte ankesa edhe nga Oda Ekonomike e Maqedonisë dhe Malit të Zi, si dhe ajo e Bosnjë Hercegovinës. Bazuar në këtë, është krijuar momentumi kur edhe Kosova duhet të jetë e përgatitur për një rishikim të tillë", ka deklaruar Gërxhaliu.

Ai ka thënë se rishikimi i marrëveshjes së CEFTA-s duhet të bëhet nga njerëz profesionistë. "Rishikimi i marrëveshjes duhet të bëhet duke u bazuar në ekspertizë dhe kuadro të cilat mund ta ndihmojnë këtë proces dhe mos të vazhdohet t'i lihet faji UNMIK-ut apo dikujt tjetër. Në qoftë se kemi pengesa nga CEFTA, e nënshkruar nga UNMIK-u, atëherë është koha kur duhet ta kemi një dokument të përbashkët i cili nuk do të duhej të kishte pengesa. Besoj se ky dokument do të ishte i kompletuar dhe në funksion të zhvillimit të vendit dhe rajonit jo vetëm në aspektin ekonomik, por edhe në atë strategjik, integrueses dhe, mbi të gjitha, për përmirësimin e imazhit të Ballkanit Perëndimor. Prandaj mendoj se duhet të ketë ekspertë të fushës të cilët nuk janë pjesë e klaneve të politikës, por që vërtet profesionin e kanë armën më të fuqishme për t'i adresuar sfidat dhe për të ndërtuar të ardhmen e bizneseve vendore", u shpreh ai.

Gërxhaliu ka theksuar se Kosova në këtë marrëveshje është nënçmuar. "Nuk është në pyetje vetëm disbalanci tregtar, pasi ky është vetëm një argument. Me të vërtetë ka pasur sfida të cilat kanë ndikuar që Kosova të jetë e anashkaluar, e dëmtuar dhe, para së gjithash, e nënçmuar. Një dukuri e tillë nuk është vetëm në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ankesa të shumta ka edhe në mes të Bosnjë Hercegovinës dhe Malit të Zi, po ashtu edhe në mes të Maqedonisë dhe Serbisë, por më tepër ka në mes të Shqipërisë dhe Maqedonisë. Besoj se të gjitha këto janë argumente që duhet të na motivojnë që të jemi më të përgatitur dhe ta ndërtojmë një dokument i cili do të jetë i barabartë për të gjithë. Nëse shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë mundësi të kenë legjislacion të harmonizuar me standardet evropiane, atëherë lind pyetja pse ato dokumente nuk janë të harmonizuara me vendet e Ballkanit Perëndimor, pasi pengesat më të mëdha i kemi në këtë pjesë. Tani është momenti i duhur që të kërkohet shqyrtimi dhe negocimi i marrëveshjes së CEFTA-s, që një veprim i tillë është në interes të të gjithëve", ka deklaruar Gërxhaliu.

I pyetur nëse mund të ketë Kosova masa penalizuese në procesin integrues në qoftë se kërkohet rishikimi apo dalja nga CEFTA, Gërxhaliu është përgjigjur: "Një ndër pikat më të dobëta që vërehet në marrëveshjen e CEFTA-s është se duhet të shikohet se a ka masa penalizuese për shkelësit e kësaj marrëveshje. Prandaj, nëse do të ketë një pikë të kompletuar, duhet vërtet të ketë edhe marrëveshje penalizuese për ata që e shkelin marrëveshjen e CEFTA-s. Nuk ka problem veç Kosova me Serbinë, por të gjitha shtetet e rajonit. Është qëndrim edhe i Odës së Maqedonisë së Veriut që dokumenti më fatal për vendet e Ballkanit Perëndimor ka qenë CEFTA. Ky dokument shumë më tepër ka dëmtuar sesa ka ndihmuar sektorin privat", ka thënë Safet Gërxhaliu.

Tahiri: 11, 15 ose 17 ministri parashihen në Ligjin për Qeverinë

PRISHTINË, 10 MARS - Projektligji për Qeverinë është në fazën e fundit të procesit të draftimit para se të kalojë për miratim në kabinetin qeveritar. Ligji, i cili në të ardhmen do ta rregullojë punën e ekzekutivit, po kalohet me konsultime të brendshme të grupit punues.

Koordinatori Nacional për Qeverisje Lokale, Besnik Tahiri, ka thënë se ky projektligj nuk prek vetëm numrin e ministrive, zëvendësministrave dhe zëvendëskryeministrave, por e rregullon ekzekutivin e shtetit, raportet ndërmjet ministrive, nismat sociale dhe saktëson përgjegjësitë dhe detyrat e secilës ministri dhe Kryeministrisë.

Tahiri, i cili është edhe kryesues i Komisionit për Hartimin e Projektligjit për Qeverinë, në një intervistë për "Ekonomia Online" për herë të parë ka bërë publike draftin e këtij projektligji. Ai ka treguar se tri opsione janë për numrin e ministrive: Qeveri me 11, 15 dhe 17 ministri. "Për herë të parë po e bëj publike, unë i kam tri opsione, opsioni me 11 ministri, opsioni që është me 15 ministri dhe opsioni me 17 ministri. Do të jetë vendim i Qeverisë cilin opsion e merr. Ka liderë seriozë të partive opozitare që mendojnë numri nuk duhet të jetë i përfshirë në këtë ligj dhe unë, nëse nuk e vendosi numrin si kryetar i këtij komisioni, nuk do ta çoj në Qeveri. Kur kemi hyrë në analizë të evidencës kemi parë që numri i ministrive ka degraduar, koalicion pas koalicioni, qeveri pas qeverie", ka thënë kryesuesi i Komisionit për Hartimin e Projektligjit për Qeverinë, Besnik Tahiri.

Intervistë me kryesuesin e Bordit Mbikëqyrës në "Trepçë", Ardian Syla

'Trepça' u regjistrua me të gjitha njës

Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës në "Trepçë", Ardian Syla, ka thënë se kjo ndërmarrje është regjistruar si shoqëri aksionare me të gjitha asetetet dhe njësitë biznesore në tërë territorin e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se njësitë biznesore dhe asetet siç janë minierat me flotacion kopaonik, metalurgjia e plumbit, laboratori në Zveçan, kompleksi administrativ në Zveçan, janë të përfshira në certifikatën e biznesit të "Trepça" sh. a. Syla ka bërë me dije se tani do ta fillojnë fazën e dytë të kompletimit të listës së aksionarëve në njësitë e tjera

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 MARS -

"Epoka e re": *Z. Syla, javën që lamë pas "Trepça" u regjistrua si shoqëri aksionare. Nga prizmi juaj, çfarë e ardhme e pret "Trepçën"?*

Syla: Me regjistrimin e ndërmarrjes "Trepça" shoqëri aksionare ka përfunduar një proces dhe obligim ligjor i cili ka filluar në muajin maj të vitit 2018. Fatkeqësisht, ka qenë një proces i stërzgjatur. Fatmirësisht, tani ky proces ka përfunduar dhe "Trepça" sh. a. është regjistruar konform Ligjit për "Trepçën" dhe statutit të miratuar në Kuvend. Me regjistrimin e ndërmarrjes është hapur rruga për përzgjedhjen e bordit menaxhues të "Trepça" sh. a., obligim ligjor dhe më se i domosdoshëm që parashihet me ligj. Pas përzgjedhjes së bordit menaxhues përmes konkursit publik, sipas legjislacionit në fuqi, kompletohet qeverisja e ndërmarrjes. Bordi menaxhues ka për obligim përgatitjen e planeve dhe projekteve investuese nëpër njësitë përkatëse të cilat më pastaj aprovohen nga Bordi Mbikëqyrës. Angazhimi ynë maksimal do të jetë të kemi një menaxhment profesional dhe vizionar për ta avancuar gjendjen në "Trepça" sh. a. Pas përfundimit të fazës së përzgjedhjes së Bordit Menaxhues, planifikojmë të bëjmë një studim fizibiliteti si dhe vlerësim të aseteve të "Trepçës" në tërësi. Me studimin e fizibilitetit do të kemi një pasqyrë reale të gjendjes në ndërmarrje që do të na mundësojë ndërmarrjen e hapave të nevojshëm në rivitalizimin e njësive të "Trepçës". Për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të ndërmarrjes duhen patjetër investime në miniera me flotacione, të cilat janë asetet thelbësore të "Trepça" sh. a. Investimet në miniera, duke rritur kapacitetet prodhuese, gjenerojnë vende të reja të punës dhe krijojnë parakushtet për funksionalizimin e njësive biznesore në kuadër të "Trepça" sh. a. Rruga drejt investimeve të reja, sikurse ajo e rivitalizimit të njësive, kalon përmes studimit të fizibilitetit.

"Epoka e re": *Sa ishin sfiduese për ju hapat deri te certifikimi, përkatësisht regjistrimi, marrë parasysh rrethanat kronologjike që ishin?*

Syla: Marrë parasysh rrethanat kronologjike, propozimi i statutit dhe miratimi nga Kuvendi i Kosovës e deri te regjistrimi i ndërmarrjes, ka qenë një proces sfidues për shkak të specifikave të ndërmarrjes, pasi Ligji për "Trepçën" ka definuar saktë njësitë biznesore të cilat do të duhej të transformoheshin në "Trepça" sh. a. Njësitë biznesore, sipas ligjit, do të duhej të ishin minierat me flotacione të cilat janë asetet thelbësore të ndërmarrjes dhe prej të cilave gjenerohen të hyra. Por, grupet punuese të emëruara nga Qeveria kanë rekomanduar edhe dhjetë njësi të tjera biznesore në kuadër të shoqërisë aksionare. Puna e grupeve punuese në afat prej tre muajsh, shkuarja e statutit në Komision Parlamentar e deri në miratimin nga Kuvendi, bëri që të kemi vonesa në regjistrimin e ndërmarrjes. Keni parasysh "Trepça" sh. a. është modeli i vetëm i një ndërmarrje publike në Kosovë, ku punëtorët janë aksionarë. Kjo ka bërë që të kishte sfida për bordin mbikëqyrës si dhe institucionet e Qeverisë. Edhe procesi i futjes së të dhënave të të gjithë aksionarëve dhe procesi në tërësi i regjistrimit të një shoqërie aksionare ka zgjatur më shumë sesa duhej.

"Epoka e re": *A janë regjistruar të gjithë punëtorët e "Trepçës" si aksionarë të 20 përqindëshit që u takon?*

Syla: Me Ligjin për "Trepçën" parashihen dy aksionarë, Qeveria me 80 për qind dhe punëtorët në njësitë përkatëse me 20 për qind. Me kërkesë të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve (ARBRK), lidhur me dokumentacionin e nevojshëm, formuam një grup punues që kishte për obligim krijimin e dosjes për secilin punëtor në njësitë e "Trepçës". Me rastin e dorëzimit të dosjes pranë ARBK-së, kemi hasur në disa probleme, kryesisht me validitetin e dokumentacionit të të punësuarve. Dokumentacioni, i cili s'ka qenë në rregull, për arsye të ndryshme, është eliminuar dhe në këtë fazë janë regjistruar rreth 70 për qind të të punësuarve. Këto ditë fillon faza e dytë e përgatitjes së dosjeve të të punësuarve të tjerë të cilët do të dorëzohen brenda pak kohe pranë ARBK-së për plotësimin e listës së aksionarëve.

"Epoka e re": *A janë përfshirë dhe punëtorët e "Trepçës" në veri?*

Syla: Sfida e integrimit të pjesës veriore edhe në këtë aspekt nuk ka kaluar pa u vërejtur. Gjithsesi, bordi mbikëqyrës, së bashku me MZhE-në, ka bërë përpjekje maksimale nga fillimi i punës për inkuadrimin e minierave me flotacion në kopaonik por që, për arsye të ndryshme, kanë refuzuar bashkëpunimin me Bordin Mbikëqyrës, kryesisht në nivelin e mikromenaxhimit të ndërmarrjes. Në nivelin e makromenaxhimit, minierat me flotacion në kopaonik bashkëpunojnë me institucionet përkatëse të Qeverisë së Kosovës, pasi që marrin aprovimet e duhura për t'i

itë dhe asetet sipas ligjit dhe statutit

bërë eksportet e koncentrateve, si dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve për licencimin nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. Lidhur me këtë, gjatë regjistrimit të njësive biznesore s'janë përfshirë punëtorët e "Trepçës" në veri, pasi nuk e kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar. Duke parë që njësia në fjalë s'ka ofruar bashkëpunimin e kërkuar, kemi vendosur që mos të mbetemi peng i njësisë, duke vazhduar regjistrimin e të gjitha njësive të tjera. Mirëpo, njësitë biznesore dhe asetet, siç janë minierat me flotacion kopaonik, metalurgjia e plumbit, laboratori në Zveçan, kompleksi administrativ në Zveçan, janë të përfshira në certifikatën e biznesit të "Trepça" sh. a. Aksionari kryesor, Qeveria e Kosovës, figuron si aksionare prej 80 përqindësh dhe ka mbetur vetëm edhe dorëzimi i listave të të punësuarve si aksionari i dytë. Por, tani fillojmë fazën e dytë të kompletimit të listës së aksionarëve në njësitë e tjera dhe ne si Bord Mbikëqyrës do të kërkojmë prapë dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e punëtorëve të njësisë minierat me flotacion kopaonik - Leposaviq. Transformimi i tillë i ndërmarrjes "Trepça", besoj se përmes aktivitetit dhe bashkëpunimit të domosdoshëm ekonomik të Qeverisë dhe punëtorëve si aksionarë në të gjitha njësitë e "Trepçës", do të ndikojë në zbutjen e raporteve dhe pashmangshmërisht do ta stabilizojë gjendjen që kemi tani. Fundja, ekonomia nuk nënkupton vetëm mirëqenie. Ajo ka edhe dimensionin social dhe kulturor, që përmes zhvillimit të "Trepça" sh. a. dhe rritjes së kapaciteteve të saj, edhe ky aspekt do të avancohet.

Auditimi do ta lehtësonte punën në "Trepçë"

"Epoka e re": *Ministri i MZhE-së ka bërë kërkesë për auditim të "Trepçës". A ka filluar auditimi?*
Syla: Bordi Mbikëqyrës, në koordinim me ministrin e Zhvillimit Ekonomik, z. Lluka, u janë drejtuar Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës për ta filluar auditimin në Ndërmarrjen "Trepça", me rastin e regjistrimit si shoqëri aksionare, pasi auditimi do të na lehtësonte punën si dhe do të pasqyronte një gjendje financiare dhe operative të ndërmarrjes që do të ishte e nevojshme edhe për aksionarët. Fatkeqësisht, për arsye të ndryshme, Auditori i Përgjithshëm ka refuzuar kërkesën për këtë periudhë. Arsyeja kryesore e refuzimit të kërkesës ishte mungesa e pasqyrave të konsoliduara financiare të ndërmarrjes si tërësi. Auditori e ka lënë mundësinë e hapur që menjëherë pas regjistrimit ta fusë në planin vjetor edhe "Trepçën". Bordi Mbikëqyrës do ta ripërsërisë kërkesën tek Auditori menjëherë pas konsolidimit të pasqyrave financiare dhe plotësimit të kushteve të tjera.

"Epoka e re": *Ju së bashku me një delegacion të Kosovës morët pjesë në konferencën ndërkombëtare të minierave dhe mineraleve 'PDAC 2019' në Kanada. Na tregoni çfarë përfitimesh pritët t'i sjellë Kosovës kjo konferencë?*
Syla: Kosova u përfaqësua nga nivelet më të larta dhe profesionale në konferencën më të madhe të minierave dhe mineraleve "Prospectors dhe Developers Association of Canada". Përfaqësimi përbëhej nga ministri i Zhvillimit Ekonomik, kryetarja e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, kryesuesi i Bordit të Trepçës, kryesuesi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale si dhe konsulli i përgjithshëm në Toronto. Ne kishim rastin të prezantojmë para delegacioneve botërore dhe investitorëve potencialë në fushën e minierave dhe mineraleve mundësitë që ofron legjislacioni në Kosovë dhe pasuritë nëntokësore. Interesimi i investitorëve për sektorin e minierave dhe mineraleve ishte i jashtëzakonshëm. Në këtë konferencë treditore patëm rastin të zhvillojmë takime individuale dhe bashkëbisedime me kompani me renome ndërkombëtare si dhe delegacione të ndryshme shtetërore.

"Epoka e re": *Në shtator është paralajmëruar një vizitë e 20 investitorëve kanadezë. Çfarë pritje keni nga kjo vizitë?*
Syla: Kompanitë dhe investitorët kanadezë në sektorin e minierave dhe mineraleve ishin në Kosovë tani e sa kohë. Gjatë vizitës në Kanada takuam edhe njërën nga kompanitë hulumtuese kanadeze e cila, gjatë hulumtimeve të bëra në Kosovë, zbuloi një sasi të përafërt prej rreth katër tonë ari në fshatin Slivovë. Prandaj, ky hulumtim dhe zbulim paraqet një shembull të mirë për gjithë investitorët potencialë. Ardhja e investitorëve kanadezë do të jetë e rëndësishme për forcimin e marrëdhënieve ekonomike në mes të dy shteteve. Legjislacioni i Kosovës ofron mundësi të shumta për investitorët potencialë, marrë parasysh që investitorët janë të njoftuar me këtë legjislacion siç është Ligji për Investime Strategjike, si dhe Ligji për "Trepçën". Presim që të konkretizojmë investime në sektorin e minierave dhe mineraleve.

BQK-ja: Borxhi publik i Kosovës ka arritur në 1.1 miliard euro

Prishtinë, 10 mars - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka njoftuar se të hyrat buxhetore deri në nëntor të vitit 2018 arritën vlerën neto prej 1.60 miliard eurosh, që paraqet një rritje vjetore prej 4.4 përqindësh. "Këto të hyra janë në kuadër të të hyrave buxhetore dhe nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim. Rritja e arkëtimit të të hyrave buxhetore erdhi si rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik, por edhe reformave të ndërmarra nga agjencitë e të hyrave që kanë për synim ngushtimin e hendekut tatimor. Sa i përket llojit të tatimeve, vërehet rritje më e lartë e të hyrave tatimore direkte të cilat arritën vlerën prej 249.3 milionë eurosh (11.8 për qind rritje), ndërsa të hyrat tatimore indirekte shënuan rritje prej 2.9 përqindësh dhe arritën vlerën prej 1.2 miliard eurosh. Të hyrat jotatimore shënuan rritje prej vetëm 0.9 përqindësh dhe arritën vlerën prej 174.2 milionë eurosh", thuhet në raportin e BQK-së "Vlerësimi tremujor i zhvillimeve makroekonomike".

Ndërkaq sa iu përket shpenzimeve buxhetore, sipas BQK-së, ato arritën vlerën prej 1.66 miliardë eurosh, që paraqet një rritje vjetore prej 13 përqindësh. Gjatë kësaj periudhe të gjitha kategoritë e shpenzimeve buxhetore u karakterizuan me rritje. "Shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje shënuan rritje prej 7.6 përqindësh dhe arritën vlerën prej 540 milionë eurosh. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe shpenzimet komunale) shënuan rritje për 17.2 përqindësh dhe arritën vlerën prej 203.7 milionë eurosh. Subvencionet dhe transferimet shënuan rritje për 13 për qind

dhe arritën vlerën prej 499.6 milionë eurosh. Investimet kapitale, të cilat përfaqësojnë rreth 25.5 për qind të gjithsej shpenzimeve buxhetore, shënuan rritje prej 18.6 përqindësh dhe arritën vlerën 422 milionë euro. Rrjedhimisht, si rezultat i rritjes më të lartë të shpenzimeve buxhetore, krahasuar me të hyrat, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 57.2 milionë eurosh krahasuar me suficitin prej 65.9 milionë eurosh në periudhën e njëjtë të vitit 2017, përderisa si përqindje e BPV-së, deficiti primar ishte 0.8 për qind", thuhet në raportin e BQK-së.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka njoftuar se borxhi publik në fund të vitit 2018 ka arritur në 1.1 miliard euro, që është për 9.7 për qind më i lartë krahasuar me vitin 2017. "Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 17.1 për qind nga 16.2 për qind sa ishte në vitin 2017. Kjo rritje e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 17.8 përqindësh (i cili ka arritur në 676.6 milionë euro), ndërsa borxhi i jashtëm publik ka shënuar rënie prej 1.4 përqindësh duke arritur në 416.1 milionë euro. Pjesëmarrja e borxhit të jashtëm publik në gjithsej borxhin publik është zvogëluar në 38.1 për qind nga 42.4 për qind sa ishte në vitin 2017. Përkundër rritjes, ky nivel i borxhit është ende larg pragut prej 40 përqindësh të paraparë me ligj. Për më tepër, ky nivel i borxhit publik e mban Kosovën në pozitën e vendit me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit, të cilat, sipas FMN-së, kanë një mesatare të borxhit publik prej 59.1 përqindësh", thuhet në raportin e BQK-së. (rtklive)

Vetëvendosjes në Prizren i bashkohet kardiologu Irfan Daullxhiu

Prizren, 10 mars (ER) - Lëvizjes Vetëvendosje në Prizren i është bashkuar kardiologu Irfan Daullxhiu, i cili është pritur në takim nga kryetari i kësaj lëvizje, Albin Kurti dhe kryetari i Prizrenit, Mytaher Haskuka. Me këtë rast, Kurti ka thënë se me doktor Irfanin Vetëvendosjes i forcohet zemra. "Qytetar i Prizrenit, student i Sarajevës, specializant i Zagrebit, dr. Irfan Daullxhiu është kardiolog i mirënjohur i Kosovës. Ai sot u anëtarësua në Vetëvendosje! dhe bashkë me kryetarin e Prizrenit, Mytaher Haskukën, i dëshiruam mirëseardhje. Dr. Daullxhiu ka qenë edhe kryetar i Shoqatës së Kardiologëve të Kosovës, i cili ka marrë pjesë në shumë konferenca ndërkombëtare profesionale dhe ka publikime të shumta në revista të huaja shkencore. Me dr. Irfanin Lëvizjes i forcohet zemra", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Disa fshatra të Suharekës përfshihen nga zjarri

Suharekë, 10 mars (ER) - Fshatrat Mushtisht, Budakovë dhe Semetisht në Komunën e Suharekës janë përfshirë nga zjarri. Lajmin e ka bërë me dije, nëpërmjet llogarisë së vet në "Facebook", kryetari i kësaj komune, Bali Muharremaj. Me këtë rast, ai u ka bërë apel qytetarëve të kenë kujdes në raport me ndezjen e zjarreve. "Në Mushtisht, Budakovë dhe Semetisht ka zjarre aktive të cilat po shkaktojnë dëme kolosale. Apeloj te të gjitha organet përgjegjëse, po ashtu edhe te qytetarët, që të kenë kujdes", ka shkruar Muharremaj.

Në shkollat e Mitrovicës ka vazhduar zëvendësimi i orëve të humbura

Mitrovicë, 10 mars (ER) - Të shtunën në shumë shkolla të Komunës së Mitrovicës, sipas dinamikës së paparë nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit, ka vazhduar zëvendësimi i orëve të humbura si pasojë e grevës së personelit arsimor.

Drejtori i Arsimit, Iset Beka, ka bërë me dije se shumica e shkollave në Komunë të Mitrovicës, me përjashtim të katër shkollave, kanë mbajtur mësimin sipas planit dhe programit të përcaktuar nga drejtorët dhe personeli në këto shkolla.

Drejtori Beka ka theksuar se në ditët e ardhshme do të mbajë një mbledhje me kryesitë e nxënësve të këtyre shkollave dhe këshillat drejtuese në mënyrë që t'i udhëzojnë dhe këshillojnë se pasojat, sidomos për nxënësit e klasave të para, të nënta dhe të dymbëdhjeta, janë të pariparueshme. "Pas vendimit të gjykatës, çdo ditë e humbur është arsyetim i kotë dhe shkon në dëm të nxënësve", ka thënë drejtori i Arsimit, Iset Beka.

Dorëzohet medikamenti 'Koate-DVI ' në QKUK

Prishtinë, 10 mars (ER) - Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) është bërë dorëzimi i medikamenti 'Koate-DVI', donacion ky që është bërë i mundshëm përmes bashkëpunimit të suksesshëm dhe të vazhdueshëm në mes "Kosovo Hemophilia Foundation" dhe organizatës ndërkombëtare "World Federation of Hemophilia(WFH)".

Në Prishtinë u dorëzua një sasi prej 500 kutive të medikamentit në formë donacioni, që e ka vlerën afërsisht 10 000 dollarë.

Medikamenti 'Koate-DVI' përdoret për t'i kontrolluar dhe për t'i parandaluar episodet e gjakderdhjes tek njerëzit me nivele të ulëta të faktorit të VIII (hemofilia A). Njerëzit me nivele të ulëta të faktorit VIII janë në rrezik për gjakderdhje më të gjatë pas një lëndimi apo operacioni, gjithashtu edhe për gjakderdhje të brendshme (veçanërisht në nyje dhe muskuj).

"Kosovo Hemophilia Foundation" ka falënderuar "World Federation of Hemophilia" për donacionin e dhënë.



Përveç heqjes së taksës, Serbia vë kusht heqjen e Platformës së Kosovës për vazhdimin e dialogut

Bardhyl MAHMUTI

Përveç ankesave që presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, i shprehu në takimin me nënsekretarin për Çështje Politike në Departamentin e Shtetit, David Hale, ai, në një fjalim para rreth 6 000 qytetarëve në Mitrovicë të Sremit të Vojvodinës, volli vrer kundër miratimit të Platformës për dialog të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Mediat në gjuhën shqipe raportuan për fyerjet që presidenti i Serbisë ua adresoi politikanëve shqiptarë të Kosovës dhe atyre të BE-së. Megjithatë, revolta e Aleksandar Vuçiqit lidhur me platformën që miratoi Kuvendi i Kosovës del hapur në fjalimin e tij të mbajtur në Mitrovicë të Sremit.

E shoh me interes që lexuesi shqiptar të njoftohet më gjerësisht rreth këtij fjalimi. Për këtë arsye kam bërë përkthimin e pjesëve që më janë dukur më domethënës dhe që nxjerrin në shesh se ku i djeg Serbisë!

Ndër të tjera, në këtë fjalim presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq thotë: "Të dashur miq. Dje ka ndodhur diçka e rëndë; shqiptarët kanë sjellë platformë! Ju lus që të dëgjoni se çka shkruhet në atë platformë. Kanë sjellë Platformë… Kam menduar se pafytyrësia ka kufij, por dje kam kuptuar se pafytyrësia nuk ka fund!

Në atë platformë kanë shkruar se ne duhet të njohim pavarësinë e tyre, ta njohim menjëherë! Madje as kjo nuk u mjafton! Ta njohim në kufijtë e sotëm të Kosovës që ata të mund të na njohin një ditë dhe të na i falin një ditë të gjitha mëkatet. Ky është vetëm parakusht, që ne të tregojmë shenja besueshmërie që ata të kenë më shumë besim te ne, që të mund ta pranojnë Serbinë! Paramendoni veprojnë sikur ne të mos ishim shtet dhe sikur na ka mbetur që ata të na njohin! Dhe për këtë arsye flasin për njohje reciproke. Sikur të mos ishte e pikëlluese do të kishte qenë qesharake. Kjo i bie sikur ne presim që ata të na njohin neve, që na njeh krejt bota, neve që jemi themelues të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Na flasin se si është mirë që të ketë njohje reciproke! Dhe kjo është cikërrimë në krahasim me atë që vijon.

Ata thonë se Serbia duhet të përgjigjet për krimet seksuale të kryera ndaj shqiptareve! Pastaj thonë se Serbia dhe serbët duhet të përgjigjen për të gjitha krimet tjera që janë kryer ndaj shqiptarëve, dhe ne me të gjithë këto kërkesa duhet vullnetarisht të pajtohemi! Të krijohet një gjykatë e veçantë për krimet që kanë kryer serbët. Edhe kjo nuk është e mjaftueshme! O njerëz, do të duhet t'u paguajmë dëmshpërblimet e luftës, ndoshta për arsye se kanë bërë ndarjen e dhunshme të një pjese të territorit tonë përmes agresionit që ka kryer Pakti NATO; ndoshta për këtë do të duhet t'u paguajmë dëmshpërblime lufte. Dhe e gjithë kjo nuk është e mjaftueshme! Do të duhet të plotësojmë edhe pesë kushte të tjera që ata, të 'mëdhenjtë e kësaj bote', jo ta harrojnë, por të na e falin, dhe ata të na njohin në një moment të caktuar! Dhe kur i shihni të gjitha këto ju e kuptoni se shqiptarët kanë sjellë vendim që të mos ketë dialog! Kanë sjellë vendim që të mos ketë kurrfarë bisedimesh! Dëshira e tyre është ta ulin sa më pushtë Serbinë.

Kemi dashur kompromisin dhe gjithmonë e kemi kërkuar. Edhe sot themi se dëshirojmë kompromis, por për atë që të shkatërroni Serbinë, ta asgjësoni Serbinë, ta shkelni Serbinë nuk do të mundni as ju, siç nuk kanë mundur edhe shumë më të fortë se ata të Prishtinës që janë përpjekur në qindra vjet para tyre…Po u them se nuk ka më 'Oluja'! Nuk ka më 'Blesak'! (Këtu aludohet në ofensivat kroate që çliruan përfundimisht çdo pjesë të Kroacisë që mbahej nën okupimin serb). Dhe e di mirë se çka ju them kur shqiptoj këto fjalë. Dhe ju bëni llogaritë mirë. Bëni llogarit mirë dhe përpiquni të luani. Ne nuk do ta ngucim askënd! Asnjëherë nuk do të provokojmë asnjë konflikt! Por do të kërkojmë paqe dhe do të kërkojmë bisedime. Ndërsa ju kur të hiqni platformën tuaj dhe kur do të hiqni taksat e juaja, atëherë mirë se vini në bisedime, pa marrë parasysh se çfarë rrenacakësh jeni!".

Mendoj se ky fjalim e nxjerr sheshit pse Serbia nuk është e gatshme të hapë një kapitull të ri në raport me shqiptarët në përgjithësi dhe atë të Kosovës në veçanti!

Koordinatori Hoti: Stabiliteti në Ballkan varet nga kreativiteti kulturor, dituria dhe sporti

NOVI PAZAR, 10 MARS (ER) - Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rexhep Hoti, ishte i ftuar si panelist në diskutimin mbi bashkëpunimin në fushën e kulturës dhe të sportit në procesin e krijimit të stabilitetit rajonal në Ballkan, që u organizua nga Këshilli Kombëtar Boshnjak në Novi Pazar.

Hoti ka thënë se Republika e Kosovës është ndërtuar mbi parimin e respektimit të të drejtave dhe lirive të komunitetit joshumicë. "Liria e komuniteteve joshumicë është pasuri e komunitetit shumicë. Ne, shqiptarëve, nuk na ka penguar kurrë liria e të tjerëve. Ne vetëm kemi kërkuar lirinë tonë. Sot jam këtu për ta shpalosur programin që s'ka të bëjë me politikë, por ka të bëjë vetëm me nxënësit dhe studentët. Në qoftë se i bashkojmë brezat e të rinjve tanë tash, e formojmë bashkë të ardhmen. Kjo është e drejtë që i takon së ardhmes dhe mbi të cilën ndërtohet ajo. Pra, ne duhet të lidhemi nëpërmjet dijes, sportit dhe kreativitetit kulturor në mënyrë që ta thellojmë bashkëpunimin dhe të krijojmë stabilitet dhe paqe në Ballkanin Perëndimor. Duhet t'ua ofrojmë mundësinë nxënësve dhe studentëve të Sanxhakut dhe nxënësve të Republikës së Kosovës ta kenë të përbashkët Lojën dhe garën në të tria fushat që ofron Programi Nacional për Rininë", ka thënë Hoti.

Pjesë e panelit ishte edhe deputetja e Kuvendit të Kosovës, Emilija Rexhepi dhe kryetari i Komunës së Bujanocit, Shaip Kamberi, të cilët vlerësuan lart Programin Nacional për Rininë, duke thënë se ndikon në të mirën e të rinjve.

Kryetari Kamberi u shpreh në mbështetje të programit dhe tregoi se ky program ka filluar të zbatohet në Bujanoc, me ç'rast tha se kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me koordinatorin Hoti.

Në fjalën e vet, anëtari i Këshillit Kombëtar të Boshnjakëve dhe kryetari i SDA-së ka folur për rëndësinë e vizitës së delegacionit nga Kosova. "Nga vitet e '90 deri tash kemi pritur presidentë, kryeministra, zëvendëskryeministra, duke nisur nga Tadiç, Mesiç, Erdogan e plot të tjerë, por ardhja e delegacionit të Republikës së Kosovës është më e rëndësishmja që ndonjëherë ka pasur Sanxhaku, që prej kohës që kur këtu ka ardhur Shaban Polluzha për ta shpëtuar Sanxhakun nga shfarosja totale", ka thënë Uglanin.

Pas diskutimit, Hoti dhe Uglanin vunë kurora me lule pranë pllakës përkujtimore të shtëpisë të liderit politik dhe ushtarak të Sanxhakut, patriotit shqiptar Aqif Blyta. Po ashtu, Hoti me delegacionin nga Kosova vizituan edhe Muzeun e Qytetit, objekt ky që gjatë viteve 1941-1945 ishte shkollë shqipe dhe mbante emrin e Naim Frashërit.

Pjesë e delegacionit nga Kosova ishte edhe profesori Nexhmedin Spahiu, udhëheqësi i Shoqatës "Kosova për Sanxhakun", Ismet Azizi dhe Xhelal Shaqiri, zyrtar ndërlidhës i Zyrës së Kosovës në Beograd.

Maduro falënderon ushtrinë për besnikërinë ndaj tij

Karakas, 10 mars - Presidenti i Venezuelës, Nicolas Maduro, ka falënderuar forcat e armatosura për qëndrimin besnik dhe luftimin e grusht-shtetit të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara dhe lideri opozitar, Juan Guaido.

Gjatë një tubimi Maduro ka thënë se ndërprerja e energjisë në Venezuelë vjen si pasojë e sulmeve kibernetike nga opozita. Fjalimi i tij erdhi pas protestave të mëdha në vend.

Në qytetin Karakas disa mbështetës të Guaidos u përleshën me policinë. Maduro ka fituar mbështetjen e ushtrisë dhe aleatëve të ngushtë, Rusisë dhe Kinës, që nga momenti kur Guaido e ka shpallur veten president më 23 janar.

Qeveria e Maduros është duke u bërë çdoherë e më izoluar pasi shtetet të ndryshme e fajësojnë për krizë ekonomike që ka detyruar më shumë se 3 milionë persona të largohen nga Venezuela.

Britania në javën kritike për marrëveshjen Brexit

Kjo javë pritet të jetë vendimtare pasi Parlamenti britanik do të duhet ta votojë nesër (e martë) për herën e fundit planin e kryeministres Theresa May të rënë dakord me Bashkimin Evropian, ku gjasat janë se sërish do të refuzohet

Londër, 10 mars - Kur kanë mbetur më pak se 20 ditë nga data kur Britania do të duhet të dalë zyrtarisht nga Bashkimi Evropian, kjo javë pritet të jetë vendimtare pasi Parlamenti britanik do të duhet të votojë për herën e fundit planin e kryeministres Theresa May të rënë dakord me Bashkimin Evropian, ku gjasat janë se sërish do të refuzohet. Por çfarë pritet të ndodhë më pas nga ana procedurale.

Nesër (e martë) do të jetë vendimtare për procesin e Brexitit, i cili formalisht do të duhet të ndodhë më 29 mars, vetëm 20 ditë më larg. Parlamenti do ta votojë planin e tërheqjes së Britanisë nga BE-ja, të rënë dakord mes kryeministres britanike dhe homologëve të saj evropianë, plan i cili një muaj më parë pësoi humbjen më spektakolare në historinë e Parlamentit britanik, me mbi 200 vota kundër.

Gjasat janë se sërish do të ndodhë e njëjta gjë. Nesër (e martë) deputetët do të votojnë planin, e nëse ai hidhet poshtë, ata një ditë më pas, do të votojnë sërish nëse do duhet Britania të dalë pa marrëveshje nga BE-ja, opsion që gjerësisht hidhet poshtë, pasi gjykohet se do jetë katastrofik për të ardhmen e vendit.

E nëse deputetët nuk e pranojnë këtë opsion, të enjten do të ndodhë votimi i fundit për të shtyrë në kohë daljen e Britanisë nga BE-ja për një periudhë të pacaktuar edhe pse pritet të jetë disamujore. Por kjo do të varet edhe nga Bashkimi Evropian, të cilit i leverdis mosdalja e Britanisë nga Unioni.

Numrat në Parlament janë shumë delikat. Dilema për ithtarët e Brexit-it, mbetet të votojmë një plan që e nxjerr Britaninë nga BE-ja edhe jo siç do donin ata, thënë ndryshe një plan që quhet Brexit vetëm në emër dhe bie në kundërshtim me atë që ta kanë dëshiruar duke tradhtuar rreth 17 milionë britanikët që votuan për daljen nga BE-ja. Apo të votojnë shtyrjen e daljes, i cili teorikisht mund të çojë edhe në anulimin e Brex-it, nëse një referendum i dytë e anulon të parin.

Gjithçka është e hapur në këtë lojë dhe kushdo që thotë se di me saktësi se çfarë do të ndodhë, thjesht gënjen.

Nën presionin e kohës, shefja e qeverisë u përball me refuzimin e evropianëve për rihapjen e negociatave. Në varësi të rezultatit të takimeve të punës që po mbahen këtë fundjavë në Bruksel, ajo mund të udhëtojë atje sërish, për negociatat e fundit.

Trampi do të kërkojë edhe 8.6 miliardë dollarë për murin me Meksikën

Uashington, 10 mars - Presidenti amerikan Donald Tramp sot (e hënë) do të kërkojë nga Kongresi edhe 8,6 miliardë dollarë të tjera për ndërtimin e murit të kufirit amerikano-meksikan, raportuan përfaqësues zyrtarë amerikanë.

Trampi premtoi ndërtimin e murit i cili do të pengojë migrimin ilegal dhe tregtinë me njerëz dhe narkotikë. Shuma është gjashtë herë më e madhe sesa ajo që e ka miratuar Kongresi për projektet kufitare në çdo prej dy viteve fiskale paraprake.

Demokratët, të cilët e kundërshtojnë ndërtimin e murit dhe e konsiderojnë si të panevojshëm dhe të pamoralshëm, e kontrollojnë Dhomën e Përfaqësuesve, kështu që supozohet se ka shumë pak mundësi që kërkesa e Trampit të kalojë në Kongres.

Siç transmetojnë agjencitë botërore pa marrë parasysh nëse Kongresi do ta miratojë kërkesën, kjo mund të ndihmojë që Trampi t'i parashtrojë argumentet e tij për sigurinë e kufirit në garën e ardhshme presidenciale në vitin 2020.

Incident në ajër në linjën Stamboll - Nju Jork, 30 të plagosur

Nju Jork, 10 mars - Fluturimi i avionit "Boeing 777-300" i kompanisë "Turkish Airlines" që është nisur nga Stambolli për në Nju Jork është shoqëruar nga një incident që ka lënë të plagosur mbi 30 persona, vetëm 45 minuta para ulje në aeroportin "John F. Kenedy".

Turbulencat e forta në ajër kanë shkaktuar frikë te pasagjerët, disa prej të cilëve kanë pësuar çarje dhe fraktura të ndryshme. Dhjetëra ambulanca janë thirrur në aeroportin ndërkombëtar të Nju-Jorkut dhe kanë transportuar të plagosurit drejt spitaleve të ndryshme.

BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.

E rrallë

Ditari që 'fsheh' 260 kamionë me ar

Ditari i kohës së luftës, i një oficeri nazist, pretendon se qindra kamionë të mbushur me ar dhe sende të tjera me vlerë janë fshehur nëpër Poloni, raportojnë mediet në këtë shtet. Ditari i shkruar nga oficeri i Stasit, Egon Ollenhauer, thotë se Adolf Hitleri urdhëroi që 260 kamionë të ngarkuar me thesare të fshihen në 11 vende në Poloni për t'i fshehur ato nga Ushtria e Kuqe Sovjetike.



FOTO E DITES

Një demonstrues merr pjesë në një marshim gjatë Ditës Ndërkombëtare të Gruas në Pamplona në Spanjën veriore. /AP/

E jashtëzakonshme

Zhytësi përfundon në gojën e balenës

Momenti i pabesueshëm ka ndodhur në brigjet e Port Elizabeth Harbour në lindje të Cape Town (Afrika Jugore), kur një zhytës gëlltitet në gojën e një balene të madhe. Ekipi i zhytësve kishte shkuar për ta dokumentuar lëvizjen e sardeleve kur zhvillimet marrin një tjetër kthesë në brigjet e Port Elizabeth Harbour.

Papritur drejtuesi i këtij ekipi, Rainer Schimpft, 51 vjeç, u gjend në gojën e madhe të balenës.

BARSOLETA E DITËS

A e dini se si i jep bakshish gjakovari muzikës?
E tërheq kartën e kreditit nëpër harmonikë.

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney

Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers

Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Keni zgjedhur mënyrën më të mirë për ta kaluar ditën. Duke larguar nga vetja çdo lloj forme stresi apo tensioni që mund t'ju lëndojë.

DEMI
Sot po humbisni bastin me veten. Kishit menduar që do ta përfundonit më herët një projekt të caktuar, por nuk keni arritur aty ku donit.

BINJAKËT
Në këtë moment të jetës suaj mund të zgjidhni një mundësi që do t'ju përfshijë në të gjitha senset edhe profesionalisht, edhe personalisht.

GAFORRJA
Nuk ka mënyra specifike për t'ju pëlqyer njerëzve të ndryshëm. Nëse jeni interesante apo jo për të tjerët, nuk duhet t'ju shqetësojë kaq shumë.

LUANI
Gjithmonë ka qenë instinkti që ju ka udhëhequr. Për këtë arsye nuk keni pse planifikoni deri në detaje një situatë të caktuar sepse çdo gjë do të ndryshojë.

VIRGJËRESHA
Përpara se t'i përgjigjeni në mënyrë të pasjellshme dikujt, bëni mirë të reflektoni. Mund të ndryshojnë pozicionet tuaja në të ardhmen.

PESHORJA
Nëse doni të bisedoni me dikë kërkojini një takim. Nuk mund ta marrë me mend nga të tjerët atë që ju intereson juve.

AKREPI
Ka gjëra që mund të përmirësoni gjatë ditës tuaj, por për këtë ju nevojitet pak kohë në dispozicion. Bëni mirë t'i dëgjoni këshillat e një miku.

SHIGJETARI
Familja po ju mban peng të një kujtimi të shkuar. Por, duhet t'i bëni zgjedhjet tuaja dhe ta ndiqni momentin pa kthyer kokën pas.

BRICJAPI
Edhe pse nuk jeni në kushte të mira fizike sot, do të keni mjaft pune dhe impenjime të cilat duhet t'i zgjidhni patjetër brenda ditës.

UJORI
Nuk doni të flisni me eprorët për mangësitë e bashkëpunëtorëve tuaj, por në këtë rast do t'i hapni shumë telashe vetes.

PESHQIT
Nëse doni të ndryshoni diçka tek vetja apo në jetën tuaj, sot është dita ideale. Çdo gjë mund të fillojë të funksionojë ndryshe që sot.

Fejohet Jennifer Lopezi

Që nga muaji shkurt i vitit 2017 këngëtarja Jennifer Lopez dhe ish bejsbollisti Alex Rodriguez janë bashkë. Por, duket se tani nuk janë më të dashur, pasi çifti është fejuar. Lajmin e ka bërë me dije vetë çifti nëpërmjet "Instagram"-it. " 'Ajo tha po". Ishte fotografia që Rodriguezi e publikoi, e të njëjtën e postoi edhe JLo në profilin e saj.

Hailey Baldwin duket shumë e bukur në të zezë

Modeluesja e njohur Hailey Baldwin është fotografuar nga paparacët të shtunën në rrugët e lagjes Manhattan të Nju Jorkut. Baldwin pati të veshur një pallto të zezë e cila i rrinte shumë bukur.

Gruaja e James Jordanit nuk është e kënaqur me dukjen e tij

Balerini James Jordan ka thënë se gruaja e tij nuk është e kënaqur me dukjen e tij pasi ai, sipas saj, ka humbur shumë peshë.

Sipas "Indenpendent.ie", gruaja e tij ka thënë se balerini ka humbur 15 kilogramë dhe se asaj i duket se atij i ka mbetur vetëm lëkura dhe kockat.

Gruaja e James Jordanit nuk është e kënaqur me dukjen e tij

Balerini James Jordan ka thënë se gruaja e tij nuk është e kënaqur me dukjen e tij pasi ai, sipas saj, ka humbur shumë peshë. Sipas "Indenpendent.ie", gruaja e tij ka thënë se balerini ka humbur 15 kilogramë dhe se asaj i duket se atij i ka mbetur vetëm lëkura dhe kockat.

Ursula Kucinska, historia e një shkrimtareje spiune

E njohur me emrin Sonja, ajo hyri në rrugën e zbulimit në vitin 1930, kur krejt papritur u njoh në Kinë me zbuluesin sovjetik Rikard Sorge, pastaj me bashkëluftëtarin e ardhshëm të punës në Japoni H Ozaki dhe me Maks Kristian Kaluzen, me kombësi gjermane. Për dy vjet punë nën drejtimin e Rikard Sorges "Sonja" përvetësoi një bagazh të madh përvoje që e ndihmoi për 20 vjet me radhë në punën e saj si profesioniste. Fati i saj në shërbimet informative ishte i çuditshëm. Ajo u dekorua dy herë me urdhrin e Flamurit të Kuq.

Në vitet 1942-1943 ajo bashkëpunoi me njeriun që u bë i famshëm si spiuni atomik agjentin Klaus Fuks. Pasi doli në pension dhe u kthye në atdhe , në Republikën Demokratike Gjermane ajo u bë shkrimtare e njohur duke firmosur veprat e saj me pseudonimin Rut Verner. Periudhën e luftës ajo e tregoi më vonë në kujtimet e saj. Po si ishte rruga e saj drejt shërbimeve sekrete? Ajo u lind më maj të vitit 1907 në Gjermani në një familje intelektuale. Babai i saj përkrahte tendencat e majta, por nuk ishte komunist, ndërsa e ema ishte piktore.

Në familje ishin gjashtë fëmijë. Ursula u rrit si një vajzë çapkënë dhe energjike, ende pa arritur moshën madhore ajo mësoi të qëllonte me revolver. Në moshën 18 vjeçe mori pjesë në luftën politike për interesat e klasës punëtore, u fut në partinë komuniste. Në vitin 1930 burri i saj i parë mori postin e kryearkitektit të Shangait dhe shkoi atje bashkë me gruan. Në Kinë, Ursula menjëherë filloi të ndihmonte komunistët kinezë në veprimtarinë e tyre ilegale. Në nëntor të vitit 1930 atë papritur e vizitoi gazetari gjerman Rikard Sorge, i cili arriti ta rekrutonte duke e pagëzuar me emrin Sonja. Pa dijeninë e të shoqit apartamenti i tyre u kthye në një vend takimesh të fshehta. Pasi ngeli shtatëzanë ajo nisi të mendonte më gjatë për martesën e saj, duke menduar se do të ishte më mirë të divorcohej, pasi i shoqi ishte një njeri apolitik.

Përgjatë dy viteve ajo do të bashkëpunonte me një njeri të zotin si Sorge, i cili një ditë vendos ta lejë Kinën duke i besuar Sonjës, punën si zbuluese e pavarur të cilën ajo e bëri me dinjitet.Ajo u thirr në Moskë për tu stërvitur. Që në kohën e Sorges në vitin 1931 ata ishin dëshmitarë të agresionit japonez në Kinë, dhe pushtimit të Mancurisë. Agresioni japonez ngjalli në të gjithë Kinën, ndjenja të zjarrta antijaponeze, filloi veprimtaria aktive antijaponeze nga e cila nuk qëndronte mënjanë edhe rezidetura e Rikard Sorges.

Sepse tani Japonia zinte pozicione të favorshme strategjike gjatë kufirit sovjetikë. Qeveria sovjetike ishte në dijeni të planeve antisovjetike të klikës ushtarake japoneze. Që në fund të vitit 1932 sipas të dhënave të zbulimit sovjektik, perandori Hirohito miratoi planin e përgatitjes së luftës kundër Bashkimit Sovjetik. Në këtë rajon të Kinës i duhej Sonjës të kthehej nga Moska për vazhdimin e punës si zbuluese, tani në kushte akoma më të rrezikshme të pushtimit japonez Në fillim ajo udhëtoi në të gjithë Rusinë deri në Çekosllovaki, ku e la djalin Misha tek prindërit të shoqit. Në Moskë ajo kreu kursin për mësimin e shifrës, alfabetit Mors dhe punën me radio për lëndët shpërthyese, të cilat ajo në Mancuri duhet tua mësonte partizanëve.

Ajo e kuptoi se puna në zbulim është shumë e rrezikshme dhe e mbarsur me rreziqe të shumta. Duke e përgatitur veten për këtë mundësi ajo kërkonte gjithmonë të ishte në formë më të mirë fizike, nuk pinte duhan, nuk përdorte kafe dhe alkool, që me çdo kusht të ruante rezistencën ndaj presioneve negative të pashmangshme. Historitë e saj reflektohen dhe në veprat që ka shkruar që dallohen për energjinë dhe spontanitetin në zgjidhjen e konflikteve mes personazheve. / *Gazeta Shqip*

Holanda, nga Instagrami te kanalet, mullinjtë dhe tregjet

Në Leiden, Maastricht dhe Rotterdam, vendet më fotogjene në atdheun e Vermeer dhe Rembrandt

Piktorët e mëdhenj të Epokës së Artë, si Vermeer dhe Rembrandt, kishin kuptuar tashmë se Holanda ishte një vend ideal për peizazhet e karakterizuara nga një dritë e jashtëzakonshme. Pikëpamjet që kanë përjetuar në veprat e tyre mund të bëjnë sot një sfond madhështor për fotot e smartphone. Me disa të reja. Duke portretizuar vende sugjeruese, ndoshta për një portret, jo vetëm në kanavacë, por duke përdorur pajisje digjitale, si Instagram, tani është një praktikë e zakonshme. Këtu është një udhëzues për vendet më piktoreske në Holandë për të portretizuar ose për të marrë një pamje me efekt të madh. Janë tri qytete veçanërisht sugjeruese.

Leida – Kaluar nga kanalet që karakterizojnë pamjen e tij, Leida është një qytet i bukur në ujë dhe në pranverë dhe verë rrugët ujore janë të kryqëzuara nga anije të shumta dhe anije turistike, në bordet e të cilave ju mund të zbuloni bukurinë e Leida në një mënyrë absolutisht të ngadaltë. Leida ofron shumë mundësi të tjera për të bërë shkrepje të bukura, për shembull në Hortusin e mrekullueshëm, në kopshtin botanik më të vjetër të Holandës ose në brendësi, në shumë muze që qyteti mburret, ekspozohen objekte unike që me siguri meritojnë të përjetësohen.

Maastricht – Në qytetin më jugor të Holandës ndonjëherë duket se je në një vend të huaj. I vendosur në brigjet e lumit Meuse, i rrethuar nga kodra e kodrina dhe i pasur me ndërtesa të lashta, Maastricht karakterizohet nga një atmosferë unike. Libraria Boekhandel Dominicanen ose Kruisherenhotel janë vende ideale për një shkrepje. Libraria është e vendosur në një ish-kishë dhe konsiderohet të jetë më e bukura në botë. Hoteli Kruisherenhotel është vendosur në një ish-manastir dhe është një vend unik në aspektin e dizajnit modern në brendësi i përshtatur nga muret e lashta.

Rotterdam – Qyteti duket i bërë për Instagram. Falë aspektit industrial, portit dinamik dhe arkitekturës inovative, shumë qoshe jepen hua për të bërë një transmetim në Instagram. Mjafton të ecësh deri në Hofbogen në rrethin Rotterdam-Noord. Harqet nën vijën e vjetër të hekurudhave mbajnë dyqane të modës dhe restorante të kohës. Vetëm le të jetë i hijshëm nga pamja e jashtëzakonshme e qytetit nga çatia më e gjatë në Holandë deri në Luchtpark. Tregu i parë dhe më i madh i mbuluar në Holandë është Markthal Rotterdam, i cili zë një zonë me madhësinë e një fushe futbolli, ndërsa në çati në formë patkoi janë disa apartamente. Një element dallues i horizontit të Roterdamit është ura Erasmusbrug, një perlë arkitekturore që arrin 139 metra lartësi: e bërë prej çeliku, lidh portin historik Delfshaven me lagjen futuristike Kop van Zuid. / *Gazeta Shqip*

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE						
	ROMA - EMPOLI	1-1	DUSSELDORF - FRANKFURT	2	MALAGA - OSASUNA	1

Fitojnë favoritet për titull

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 10 MARS - Tri skuadrat favorite për titull, Feronikeli, Prishtina dhe Llapi, kanë regjistruar fitore në kuadër të javës së 22-të në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Diferenca e pikëve në mes të lideres dhe dy skuadrave përcjellëse mbetet pesë pikë. Fitores në këtë xhiro i është gëzuar edhe skuadra kampione në fuqi, Drita nga Gjilani. Gara për mbijetesë është shumë interesante pasi nga vendi i pestë e deri në vendin e parafundit diferenca në mes të skuadrave është vetëm pesë pikë.

Feronikeli - Gjilani 3-0

Skuadra e Feronikelit ka shënuar fitore 3-0 ndaj Gjilanit. "Nikli" pas barazimit ndaj Prishtinës ka marrë tri pikët e reja që e mbajnë në pozitën e parë në Superligë. Sulmuesi në topformë i Feronikelit, Kastriot Rexha, ka qenë vendimtar për skuadrën nga Drenasi, pasi ka shënuar dy gola në pjesën e parë të ndeshjes, kurse golin e tretë e ka shënuar pak minuta para fundit Mevlan Zeka. Skuadra nga Drenasi është e para në tabelë me 52 pikë. Gjilani pas kësaj xhiroje është në pozitën e gjashtë me 29 pikë të grumbulluara.

KEK-u - Prishtina 1-2

Prishtina e Mirel Josës, pas humbjes nga Llapi dhe barazimit me Feronikelin, të dielën u është rikthyer fitoreve, pasi e ka mposhtur KEK-un me rezultat të ngushtë 1-2. Shtatë minuta pasi filloi ndeshja, Diar Miftaraj i kaloi mysafirët në epërsi, kurse kapiteni Armend Dallku njëzetë minuta më vonë shënoi për 2-0. Në fillim të pjesës së dytë vendësit u rikthyen në lojë me golin e shënuar nga Egzon Qerimi, por kjo ishte e tëra që arriti KEK-u në këtë ndeshje, kurse rezultati final mbeti 1-2. Prishtina është e dyta me 47 pikë, kurse KEK-u mbetet e fundit me vetëm një pikë të grumbulluar.

Liria - Drenica 1-1

Në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Përparim Thaçi" në Prizren në mes të Lirisë dhe Drenicës nuk pati fitues, pasi skuadrat luajtën baras 1-1. Për vendësit shënoi Fatih Karahoda, kurse për mysafirët golashënues ishte Edon Pasoma. Pas kësaj xhiroje Liria pozicionohet në vendin e parafundit me 24 pikë, kurse Drenica është e pesta me 29 pikë.

Flamurtari - Ballkani 0-0

Dy skuadrat që po luftojnë për mbijetesë, Flamurtari dhe Ballkani, janë ndarë baras (0-0), në ndeshjen e zhvilluar të dielën në stadiumin "Fadil Vokrri". Rastet nuk munguan, por gola të shënuara nuk pati. Pas kësaj ndeshje Flamurtari, i drejtuar nga Arsim Thaqi, pozicionohet në vendin e shtatë me 28 pikë, kurse Ballkani është në vendin e nëntë me po aq pikë të grumbulluara.

Llapi - Trepça '89 3-1

Llapi të shtunën ka shënuar fitore para tifozëve të vet në duel me Trepçën '89, me rezultat 3-1. Valmir Veliu në minutën e 7 e shfrytëzoi një gabim të mbrojtësit Asare dhe realizoi për 1-0, por dymbëdhjetë minuta më vonë mysafirët barazuan me anë të Gëzim Rusit. Megjithatë, vendësit vazhduan me lojë të mirë dhe në minutën e 33-të e rikthyen epërsinë me golin e Ahmet Jonuzit, i cili realizoi për 2-1. Në minutën e 54-t, Diaware pati mundësi për ta barazuar rezultatin, por dështoi të shënojë nga penalltia. Rezultatin 3-1 e vulosi Festim Alidema.

Drita - Ferizaj 1-0

Të shtunën fitore ka shënuar edhe kampionia aktuale, Drita, e cila e mposhti Ferizajn me rezultat të ngushtë 1-0. Drita luajti pa ndonjë presion, sepse është jashtë garës për titull e në anën tjetër Ferizaj po lufton me të gjitha forcat për të mbijetuar në elitë. Golin e fitores për vendësit e shënoi Nwabueze në minutën e 15-të. Drita përforcon vendin e katërt në tabelë me 35 pikë, kurse Ferizaj, pas disa fitoreve radhazi dhe kësaj humbje, mbetet në pozitën e dhjetë me 24 pikë.

IPKO SUPERLIGA

Liria - Drenica	1-1
KEK-u - Prishtina	1-2
Feronikeli - Gjilani	3-0
Flamurtari - Ballkani	0-0
Drita - Ferizaj	1-0
Llapi - Trepça '89	3-1

TABELA

1. Feronikeli	22	52 pikë
2. Prishtina	22	47
3. Llapi	22	47
4. Drita	22	35
5. Drenica	22	29
6. Gjilani	22	29
7. Flamurtari	22	28
8. Trepça '89	22	28
9. Ballkani	22	28
10. Ferizaj	22	24
11. Liria	22	24
12. KEK-u	22	1

LIGA E PARË

Besa - Fushë Kosova	1-0
Vëllaznimi - Dukagjini	1-0
Trepça - Istogu	3-1
Vitia - Bashkimi	2-1
Kika - 2 Korriku	2-0
Vllaznia(P)-Vushtrria	1-0
Onix - Ramiz Sadiku	2-1
Arbëria - Drenasi	1-1

TABELA

1. Vushtrria	19	44 pikë
2. Besa	19	41
3. Dukagjini	19	37
4. Vitia	19	37
5. Vëllaznimi	19	36
6. Onix	19	31
7. Trepça	19	27
8. Arbëria	19	26
9. Istogu	19	23
10. Drenasi	19	21
11. 2 Korriku	19	21
12. Fushë Kosova	19	20
13. Kika	19	18
14. Ramiz Sadiku	19	15
15. Vllaznia	19	15
16. Bashkimi (K)	19	13

SHKURT

Shënojnë Kololli dhe Ajeti

Dy futbollistët shqiptarë që luajnë në Zvicër, Benjamin Kololli dhe Albian Ajeti, kanë shënuar për skuadrat e tyre. Kololli realizoi dy gola në ndeshjen Thun - Zurich (2-2), njërin nga penalltia. Për skuadrën mysafire luajti edhe Hekuran Kryeziu. Ndërsa sulmuesi Albian Ajeti shënoi golin e vetëm për Baselin në ndeshjen ndaj Luganos (1-1). Për skuadrën e Baselit titullar ishte edhe Taulant Xhaka, kurse Edon Zhegrova u inkuadrua në pjesën e dytë.

Muriqi shënon dy gola ndaj Kayserisporit

Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, ka shkëlqyer sot në fitoren e Rizesporit ndaj Kayserisporit (3-0). Sulmuesi shqiptar ka shënuar dy gola në këtë ndeshje, kurse një tjetër e ka shtuar Braian Samudio.

Sërish shënon Zeneli

Arbër Zeneli ka shënuar përsëri për klubin e tij, Stade de Reims, në barazimin 1-1 kundër Dijonit, në kuadër të xhiros së 28 të Ligës 1. Reprezentuesi i Kosovës shënoi në minutën e nëntë të ndeshjes, duke e kaluar skuadrën e tij në epërsi me rezultat 1-0. Megjithatë, vetëm katër minuta më vonë rezultati u barazua, pasi Naim Sliti shënoi për klubin vendës nga pika e penalltisë.

Prishtina sërish e mposhti Rahovecin

Prishtina e ka vazhduar ecurinë e jashtëzakonshme të këtij stinori në Superligën e Kosovës, duke mbetur ende skuadra e vetme që i ka fituar të gjitha ndeshjet deri më tani. Sonte bardhekaltrit e mposhtën Rahovecin me rezultat 89:70, në ndeshjen e cila u zhvillua në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve. Yjet e kësaj ndeshjeje për skuadrën e Prishtinës ishin Divine Myles me 22 pikë të shënuara, Mikaile Tmusic me 16 pikë dhe Valon Bunjaku me 14 pikë. Ndërsa, nga skuadra e Rahovecit u dalluan Frederick Richardson me 20 pikë, Deshon Minnis me 15 pikë dhe Arian Qallaku me 12 pikë.

Lenjani: Çudi, nuk jam ftuar në kombëtare

Kombëtarja e Shqipërisë pas 12 ditësh do ta zhvillojë sfidën e parë për kualifikueset e "Euro 2020", ku do ta presë përfaqësuesen e Turqisë. Lista e lojtarëve të grumbulluarve ende nuk është bërë me dije, por gjithsesi polemikat duket se kanë nisur edhe përpara se të dalë zyrtarisht. Ermir Lenjani ka reaguar në llogarinë e tij në "Instagram", duke shkruar: "Çuditërisht nuk jam ftuar për ndeshjet e muajit mars nga Kombëtarja…". Mbrojtësi i majtë po zhvillon një sezon mjaft pozitiv në Zvicër, teksa ka qenë pjesë kyçe e Sionit, ndërsa në dy ndeshjet e fundit ka munguar për shkak të dëmtimit.

Xhaka dhe Arsenali mposhtin Unitedin

LONDËR, 10 MARS - Skuadra e Arsenalit e ka fituar derbin e kësaj xhiroje në Premierë Ligë ndaj Manchester Unitedit me rezultat 2-0. Vendësit e nisën më mirë ndeshjen dhe pas dymbëdhjetë minutave lojë shënuan nëpërmjet shqiptarit Granit Xhaka, i cili me një goditje nga largësia e mposhti portierin David De Gea. Unitedi u përpoq të barazojë, por nuk arriti të shënojë. Në anën tjetër, Arsenali e shënoi edhe golin e dytë dhe të fitores në minutën e 69, kur nga penalltia i pagabueshëm ishte Pierre-Emerick Aubameyang. Përderisa Xhaka ishte më i miri në fushë, Shkodran Mustafi nuk u inkuadrua fare në lojë. Pas kësaj xhiroje Arsenali është ngritur në pozitën e katërt me 60 pikë, kurse Unitedi është një pozitë më poshtë me dy pikë më pak.

Loriana Kuka, e argjendtë në Marok, Fationa Kasapi në Kroaci

PRISHTINË, 10 MARS - Loriana Kuka ka fituar sot medaljen e argjendtë në Grand Prixin e Xhudos "Marrakech 2019" të Marokut. Xhudistja e Kosovës pësoi humbje në finale nga gjermania Ana Maria Wagner, kategoria deri në 78 kilogramë. Deri në finale Loriana fitoi tri luftëra, ndërsa raundin e parë e kaloi pa luftë. Kuka fitoi 490 pikë Olimpike për Lojërat Olimpike "Tokio 2020". Medalje të argjendtë, të parën në karrierë, e ka fituar edhe Fationa Kasapi në Kupën Evropiane për Kadete që u mbajt në Zagreb të Kroacisë. Kasapi shënoi pesë fitore me ippon, kategoria -57 kg. Në këtë garë medalistja e bronztë në Lojërat Olimpike për të Rinj, Erza Muminoviq, zuri vendin e shtatë, kategoria -48 kg. Arbër Nikçi u ndal në luftë e parë.

Derbi i takon Besës

FERIZAJ, 10 MARS - Kampionia aktuale në Superligën e meshkujve në hendboll, Besa Famgas, ka barazuar pikët me Kastriotin në krye të tabelës, pasi e ka mposhtur këtë skuadër në Ferizaj. Superderbin e fortë të luajtur para 1 200 shikuesve, Besa e fitoi me rezultat 23-22, me gol të shënuar në sekondën e fundit. Ishte Idrizi që shënoi golin e fitores në sekondën e fundit të ndeshjes. Tani dy skuadrat e para i kanë nga 36 pikë dhe gara e fortë mes tyre për vendin e parë dhe për titull pritet të vazhdojë deri në fund të kampionatit. Kastrioti ka nisur më mirë ndeshjen duke krijuar epërsi 5-1 e 6-2, por pejanët nuk janë ndalur dhe kanë barazuar rezultatin në minutën e 20 (6-6). Më pas kanë kaluar në epërsi me një gol. Por, të udhëhequr nga Terziqi, Kastrioti ka mbyllur pjesën e parë me një gol epërsi, 11-10.

Lojë e fortë ka vazhduar edhe në pjesën e dytë. Kastrioti ka krijuar epërsi 13-10 e 14-11, por lojtarët e Besës kanë vazhduar me angazhim dhe kanë kaluar në epërsi 17-16 në minutën e 45. Në minutën e 50 Besa krijoi epërsi prej dy golave, 20-18. Kastrioti sërish ktheu epërsinë 21-20, por Besa shënoi dy gola për 22-21. Afrikani që debutoi për Kastriotin, Bassomben, shënoi në minutën e fundit për 22-22, por Besa pati edhe disa sekonda për aksion dhe e shfrytëzoi maksimalisht kohën për ta shënuar gol dhe për ta fituar derbin e madh.

5 humbje radhazi, lakersi rrezikon seriozisht 'play-off'-in

LOS ANGELESE, 10 MARS - Lakersi nuk arriti ta bëjë kthesën ashtu sikurse pritej, ndaj "play-off"-i mbetet një ëndërr edhe këtë sezon për skuadrën kaliforniane, që sot u mund 120-107 nga Bostoni. Pas një pjese të parë të ekuilibruar, në të dytën erdhi shkëputja e Bostonit, ku u dallua Irvingu me 30 pikë (6 lojtarë të Celticsit realizuan mbi 10 pikë). Për Lakersin shkëlqeu i zakonshmi LeBron James, që realizoi një "triple double", 30 pikë, 10 rebounde e 12 asistime, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Lakersi ndodhen në vendin e 11-të, shumë larg 8 skuadrave të para që shkojnë në "play-off". Pa probleme fiton skuadra e Milwaukees, që mundi 131-114 Charlotten, ndeshje që u vendos në periodën e katërt në favor të skuadrës vendëse. Antetokounmpo realizoi 26 pikë, mbështetur edhe nga Lopezi me 25, një dyshe që bëri diferencën për Bucksin. Fiton edhe Portlandi, që mposhti 120-107 Phoenixin, ndeshje e dominuar nga basketbollistët vendës, ku më i miri në parket ishte McCollum me 26 pikë (65 pikë erdhën nga lojtarët e stolit). Sacramento triumfoi 102-94 në fushën e New Yorkut,

sfidë ku miqtë dominuan në minutat e fundit dhe triumfuan falë Foxit që realizoi 30 pikë. Koha shtesë nderon skuadrën e Minnesotas, që mundi 135-130 Washingtonin, sfidë me emocione dhe rivalitet. Townsi ishte shënuesi më i mirë, me 40 pikë e 16 rebounde për vendësit. Në sekondat e fundit triumfon Brooklyn, që mundi 114-112 Atlantën jashtë fushës, sfidë ku Dinwiddie realizoi 23 pikë (7 lojtarë të Netsit realizuan mbi 10 pikë).

REZULTATET

New York - Sacramento	94-102
Atlanta - Brooklyn	112-114
Minnesota - Washington	135-130
Lakers - Boston	107-120
Milwaukee - Charlotte	131-114
Portland - Phoenix	127-120

SHKURT

Zidane në bisedime me Juven

Ish-trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, është zgjedhja e parë e Juventusit nëse Massimiliano Allegri largohet në verë, që duket shumë e mundshme, pavarësisht prej rezultatit kundër Atletico Madridit këtë të martë në Ligën e Kampionëve. Sipas gazetës "La Stampa", Zidane ndodhet në Torino në këto dy ditët e fundit dhe tashmë e ka shfrytëzuar rastin të flasë me përfaqësuesit e klubit. Ish-bashkëlojtari i tij te Juve, Amoruso, i ka ndezur thashethemet edhe më shumë, duke e publikuar një fotografi nga ndeshja e tyre e vitit 2016 në futboll të vogël me Ciro Ferraran dhe Mark Iulianon në "Instagram".

Trappi, synim i Interit

Interi është në kërkim të një alternative të Samir Handanoviqit për portën dhe emri i parë në listën e drejtuesve është ai i portierit të Eintracht Frankfurtit, Kevin Trapp, i cili është në pronësi të Paris Saint-Germainit. Përballja në Evropa Ligë duket se ka shërbyer për drejtuesit zikaltër për ta parë nga afër 28-vjeçarin, i cili po bën një sezon mjaft të mirë në Gjermani. Trapp u bashkua me Frankfurtin verën e kaluar në huazim për 1 sezon, pasi në Paris mbërriti Gianluigi Buffon. Interi shpreson të arrijë një marrëveshje me francezët në mënyrë që ta transferojë 28-vjecarin në "San Siro" verën e ardhshme.

Pepe, synim i Bayernit

Nicolas Pepe duket se është synimi kryesor i Bayern Munchenit për afatin kalimtar të verës. "Sky Sport" ka raportuar se mesfushori ofensivë do t'u kushtonte shumë "bavarezëve". Bëhet fjalë për një shifër rreth 60 deri në 80 milionë euro. Sipas së përditshmes franceze "Le 10 Sport", drejtuesit e Bayernit kanë nisur negociatat me skuadrën e Lilles për lojtarin.

Dembele rrezikon ndeshjen ndaj Lyonit

Barcelona po përgatitet për ndeshjen e kthimit kundër Lyonit. Sfida e parë e zhvilluar në Francë u mbyll në barazim pa gola, ndërsa ajo e kthimit do të luhet të mërkurën në mbrëmje. Barcelona rrezikon të jetë pa Osman Dembele, pasi ai pati probleme në ndeshjen e kampionatit kundër Vallecanos. Francezi u detyrua t'i lindte vendin brazilianit Arthur në pushim të ndeshjes, pasi ndjeu dhimbje në këmbën e djathtë.

Napoli kërkon 100 milionë euro për Insignen

Napoli ia ka vënë çmimin 100 milionë euro sulmuesit anësor italian Lorenzo Insigne, raporton "La Gazzetta dello Sport" të dielën. Insigne nuk është i kënaqur te Napoli dhe për shërbimet e tij kanë shprehur interesim Manchester City, Liverpooli dhe Paris Saint-Germaini. Derisa në të kaluarën presidenti i Napolit, Aurelio De Laurentiis, nuk dëshironte të dëgjonte oferta për Insignen, tash mësohet se situata ka ndryshuar. Ai është i interesuar ta shesë Insignen, por çmimin ia ka vënë 100 milionë euro. Insigne mësohet se është i frustruar te Napoli në mungesë të fitimit të trofeve.

Unitedi dhe PSG-ja, në garë për Coutinhon

Philippe Coutinho pritet të largohet nga Barcelona në fund të këtij edicioni. Mesfushori brazilian nuk po arrin të bindë me lojën e tij me klubin katalunas dhe nuk është një titullar i padiskutueshëm. Manchester Unitedi mbetet skuadra më e interesuar për t'i fituar shërbimet e mesfushorit brazilian. "BBC" ka raportuare se "Djajtë e Kuq" janë të gatshëm të ofrojnë 100 milionë funte për transferimin e Coutinhos. Interesim për lojtarin ka shfaqur edhe kampioni në fuqi i Francës, Paris Saint Germain.

Autor: GAZMEND MORINA	FATKEQËSI E MADHE, KOB	PJESË E ILIRISË	SËPATË E VOGËL	FAZAT	HIT NGA GRUPI MUZIKOR "NRG BAND"	BASHKËT.	PËREMËR PRONOR	RRETHI QË VIHET NË NJË BOSHT DHE QË RRO-TULLOHET	SHKRIMTARJA KADARE	PERANDOR ROMAK	EPOKA E RE
AKTORJA ANGLEZE NË FOTO											RAMADAN AVDIU
GJENDJE PLOGËSHTIE SHPIRTËRORE						BOJAXHI					
VIGAN						I THAVA / RAPSODI HASHIM					
QULL I TRASHË ME MIELL MISRI							ASSOCIATION NEWS ONLINE / SHTET NË AMERIKË				ISH FUTBOLLISTI ..... RRAKLI (shq.)
EPOKA E RE	IPSVICH / QYTET I MADH NË GJERMANI		ARSENAL / LLOJ MINERALI (shq.)		ANITA KOSUMI / KLUB FUTBOLLI NË SPANJË			TENISTJA KURNIKOVA / SHTIRËSI			
ZANORE		ZBUKUROJ ME STOLI / ARBEN MALAJ							ILION LIKA / SMIRË		
NJË E HAPUR E NJËRËS KËMBË PARA				KËNGËTARI ..... ARIFI / DESPOTI						TOTENHAM / KËNGËTARJA E FAMSHME ..... CAREY (shqip.)	
EPOKA E RE	KEQTINGË-LLIM	ZAKON, TRADITË	AKTORJA E FAMSHME ..... CRUZ (shqip.)	ARMATA REPUBLIKANE IRLANDEZE (shk. orgj.)	VOZË E MADHE DRURI QË SHËRBEN PËR TË MBAJTUR DJATHË	E PESHOVA / ERMELINDA MEKSI					KRYEHOXHA / AKTORJA AMERIKANE ... FARIS					
KOMANDANTI I NJË ANIJEJE								LUMË I MADH NË HUNGARI / TREGU					NJË PLANET				
ANËTARËSIM NË NJË ORGANIZATË							MJET I VOGËL KUZHINE / KURIFI, CAKU						DAFINË (shq.) / KAFSHË GJITARE BREJTËSE				
AKTORI TURK IMIRZALIOGLU						NOTË MUZIKORE / KORNIZË			METODË STUDIMI / BASKETBOLL-ISTI TURK OMER								NJËRA NDËR TRI GJINITË KRYESORE TË KRIJIMTARISË LETRARE
OVERLAND TRAIL ELEMENTARY				SHTET FEDERAL NË SHBA / NJË PREJ FIGURAVE STILISTIKE							EDI MARFI / BERAT LUZHA			"JEMENI" / UDHËHEQËSI I NJË PARTIE		
BASHKËT.		I LARMI / MODELJA KRASNIQI								BEDRI PEJANI / ISH PORTIERI GJERMAN OLIVER			LAMBERT ACADEMIC PUBLISHING / KËNGËTARJA .... ISTREFI			
GAZ QË PËRDORET PËR TË PASTRUAR MIRË PLAGËT					KËNGËTARJA .... KONÇI / FILMI I PARË SHQIP				AKTORI HOLLIVUDIAN XHORXH ..... / FILOZOFI GJERMAN IMANUEL						ZANORE / I FILLOVA	
RUBË, MARAMË (sh.shq.)						AKTORJA ..... KURTI / TAJVANI, INDONEZIA						TENISTI I FAMSHËM ENDI ..... / AQ SA DUHET (krah.)					
INDIUM			MBARËSIA / GATESA					PUSIA	AGENCIA NACIONAL TRANSITO / BËRJA MË I RI				AKTORJA AMERIKANE .... SOFER / FUTBOLLISTI RAFAEL ..... (Real Madrid)				
EPOKA E RE	TË DHËNËT SHPIRT, HEKË / FAQJA E PJERRËT E NJË MALI						FOSFOR, RADIUM, AZOT / EMINE (perkdh.)				DËMTIM I NJË MAKINE GJATË PUNËS / ENI LENOKS						NITROGJENI
BASHKËT.		TOKA E BUKËS / AKTORI ZHITOPOTOKU				SKUQJA E LËKURËS NGA ZGJERIMI I KAPILARËVE / AKTORI AM. SANDLER								REGJISORI ... QOSJA / KASOLLE PËR KAFSHËT			
SHPEND ME QAFË TË GJATË E ME SQEP TË MADH					"ASHTU QOFTË" / KËNGËTARJA ... KOÇI					NJOLLA / KOHË					AGIM ZAJMI / PATRIOTI BOLETINI		
SHOUMENI ... KRASTA				BOTIM / ELIZABETH TAYLOR							SHAKA, SHPOTI / "RISANI"					ZANORE / EDI RAMA	
PËRSHËNDE-TJE ALLATURKA NË SHENJË NDERIMI TË THELLË							HYJNI E DASHURISË (mit. romake) / INTER					FEMRAT E SAPOMART-UARA / NANCY					
KOPJIMI								RRUGËTIMI I TRENAVE									

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite - Ministry of Labour and Social Welfare

Divizioni për Burime Njerzore - Divizija za Ljudske Resurse - Division of Human Resources

datë 08.03.2019

Divizioni për Burime Njerëzore për konkursin e publikuar më datë 28.02.2019 në gazetën ditore "Epoka e Re" në ueb faqen e MPMS-së, bënë këtë :

NJOFTIM
Mbi anulimin e konkursit për vendin e punës:

Zyrtar për Koordinim të Politikave, numër reference RN00004389

Anulimi i konkursit bëhet për shkaqe procedurale. vetëm për pozitën e lartëpërmendur,

datuma 08.03.2019

Divizija za Ljudske Resurse za konkurs objavljen datuma 28.02.2019 u dnevnom listu " Epoka e Re", u veb stranici MRSZ-a, objavljuje ovo:

OBAVEŠTENJE
O Anuliranju konkursa za radno mesto:

Službenik za Koordinaciju Politika, referentni broj RN00004389

Anuliranje ovog konkursa objavljuje se zbog proceduralnih razloga, samo za gorepomenute pozicije.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetska Bolnicka I Klinicka Sluzba Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Spitali Përgjithshëm Ferizaj(SPF) - Opsta Bolnica Urosevac(OBU) - Hospital General Ferizaj (HGF)

Drejtoria e spitalit përgjithshëm të Ferizajt, bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dhe neni 4 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe neni 5 i Rregullores Nr.1003/2016 mbi marrëdhënien e Punës të SHSKUK-së, si dhe kërkesa elektronike e dt.06.02.2019 nga drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK. Me datë 11.03.2019 shpallë këtë:

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë Kandidatët Mjekë – specialistët e interesuar se Konkursi i shpallur më datën 22.02.2019 për Pozitat:

- specialist gjinekolog, një (1)
- specialist infektolog, një (1)
- specialist mjekesi interne, tre (3)
- specialist neonatolog, një (1)
- specialist neurolog, një (1)
- specialist oftalmolog, një (1)
- specialist i orl, një (1)
- specialist radiolog, një (1)
- specialist reumatolog, një (1)
- specialist urolog, një (1)

me numër te referencës 156/19në Gazetën ditore ,, Epoka e Re ", **PJESËRISHT** vazhdohet edhe për tetë (8) ditë kalendarik, nga data: 11.03.2019 deri më datën 18.03.2019
Të gjithë Kandidatët të cilët kanë aplikuar në afat dhe procedure te rregullt për këtë Pozitë, nuk kanë nevojë për ri-aplikim.

Drejtor Ekzekutiv

Dr.Jeton Zeqiri

Direkcija Opšte bolnice Uroševac, na osnovu člana 8 Zakona o radu Br.03 / L-212 i Odeljka 4 Administrativnog uputstva (MRSS) br. 07/2017 o regulisanju procedura javnog konkursa i člana 1003/1016 o radnom odnosu SHSKUK, kao i elektronski zahtjev od 06.02.2019. Godine od strane generalnog direktora SHSKUK-a. Dana 11.03.2019.

Press

Objavljeni svi doktori - specijalisti Zainteresovani da je konkurs objavljen 22.02.2019 za pozicije:

- Specijalista za ginekologa, jedan (1)
- Infektolog, jedan (1)
- Specijalista interne medicine, tri (3)
- Neonatolog specijalista, jedan (1)
- Neurolog specijalista, jedan (1)
- Specijalista oftalmologa, jedan (1)
- specijalista za orl, jedan (1)¬
- specijalista radiolog, jedan (1)¬
- R specijalista reumatolog, jedan (1)
- Specijalista urologa, jedan (1)

Sa brojem 156/19 u listu "Epoka e Re", PARTIALNO traje osam (8) kalendarskih dana, od: 11.03.2019. do 18.03.2019.
Svi kandidati koji su se prijavili za ovu poziciju na vrijeme i na pravilan način ne trebaju ponovnu primjenu.

Izvršni direktor

Dr.Jeton Zeqiri

DRINI I BARDHË

K.R.U. "Drini i Bardhë" SHA
Rr. Mbretëresha Teutë nr.85
www.krudriniibardhe.com

Në bazë të Ligjit për Ndërmarrje publike Nr.03/L-087, Kodit të etikës dhe qeverisjes korporative mbi Ndërmarrjet Publike dhe statutit të Kompanisë Kryeshefi Ekzekutiv i KRU"Drini i Bardhë" Sh. A. - , vendosi të shpallë këtë:

K O N K U R S

Pozita: **Inkasantë sezonal për teren.**
I përgjigjen: Kryeshefit Ekzekutiv dhe Menaxherit të Njësisë.
Vendi: Pejë: 3, Istog: 3, Deçan: 3, dhe Junik 1.

Kushtet dhe kualifikimet e kerkuara:
Menaxhmenti dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.
Përveq këtyre kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- të kenë përgaditje shkolla fillore përparesi shkolla e mesme,
- përvoja e punës në këtë profesion është përparesi,
- të ketë integritet të lartë moral e profesional,
- të mos jetë i dënuar ose nën hetime,
- personat me banim në vendin ku kërkohet punëtori kanë përparësi,
- kontrata është sezonale, me mundesi vazhdimi për punëtoret qe tregojnë përformance të mire gjatë sezonës.

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:
I punësuari do të kryej këto detyra të punës:
- Të ujtarit në kanalet e ujitjës, ne fillim të sezonës merrë pjesë në pastrimin e kanaleve të ujitjës, shpërndan ujin për ujitje gjatë sezone, bënë kontraktimin e ujit, kryen pagesat nga fermerët, përgadit objektet për dimër, si dhe kryen punë tjera sipas kërkesës së KE dhe Menaxherit të Njësive Punuese.

Procedura e aplikimit:

Dokumentet dorezohen ne zyren nr 1 te KRU "Drini i Bardhë'' rruga "Mbretëresha Teutë" Nr. 85 Pejë.
Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:
- CV-ja (Biografia),
- Kopja e leternjoftimit,
- Diplomën shkollore për kualifikimin e kërkuar - kopje,
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj.

Afati për dorëzimin e aplikacioneve është 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit dhe përfundon në ora 16:00, të ditës gjegjësë.



Jaffa
Champion
PLUS
A+C+E
Multifrutti
Taste of World Wide Brand!
2L
Jaffa
Champion

American
Taste
SINCE
1905
RC
cola
RC
Refresher
BITTER
LEMON
Lime
2L

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

SHPALLJE E REKRUTIMIT

Komuna e Kaçanikut, në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 si dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të konkursit në Sektorin Publik, më 11.03.2019 shpallë konkursin për plotësimin e vendit të lirë të punës:

I. Mirëmbajtës i objekteve sportive - 2 ekzekutues
Drejtoria: për arsim dhe kulturë
Njësia/sektori: i kulturës
Koeficienti aktual- 4
Numri i referencës së vendit të punës: 111/01-6848/19
Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Është përgjegjës për mirëmbajtjen e objekteve sportive
2. Kujdeset për pasurinë e institucionit brenda dhe jashtë objektit
3. Kujdeset për mjetet e punes dhe materialin shpenzues për mirëmbajtjen e higjienës
4. Harton listën e nevojshme për mirëmbajtjen e higjienës së objektit
5. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi i tij.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilat kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedura e konkurimit: është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit ekzistues.
Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja dhe atribute tjera që kërkohen:

- Diplomë e shkollës së mesme
- Përvojë pune (e dëshirueshme)
- Shkathtësi në komunikim ;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të konkursit në Sektorin Publik .
Kohëzgjatja e emërimit : pa afat të caktuar
Data e mbylljes së konkursit; Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik, prej 11.03.3019 deri më 29.03.2019 .
Paraqitja e kërkesave: Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar **-Zyra e pranimit,** kati përdhesë dhe në web-faqen komunale .
Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente: Diplomën e shkollës së kryer apo Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën-ekstraktin e lindjes, vërtetimin e përvojës së punës, dëshminë se nuk është në hetime.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë". "Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qëndrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës"

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.
Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.

Kryetari i Komunës
Besim Hazi

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

OGLAS REGRUTOVANJA

Opština Kačanik, na osnovu člana 8 Zakona Rada Br.. 03/L-212 ,kao i Administrativnog Uputstva Br. 07/2017 O Regulisanje procedura konkursana javnom sektoru dana 11.03.2019 objavljuje konkurs o popunjavanju slobodnog radnog mesta :

I. Održavanje sportskih objekata- 2 izvršitelja
Uprava: Uprava Obrazovanja i kulture
Odelenje/sektor kulture
Aktuelni Koeficient- 4
Broj reference radnog mesta: 111/01-6848/19
Zadaci i Odgovornosti

1. Odgovoran je za održavanje sportskih objekata
2. Bavi se imovinom institucije unutar i izvan objekta
3. Održavanje radnih alata i potrošnog materijala za održavanje higijene
4. Izrađuje potrebnu listu za održavanje higijene objekta
5. Obavlja i druge poslove u skladu sa zakonima i propisima koji se razumno zahtevaju s vremena na vreme sa strane njegovog / njenog;nadzornika;

Uslovi učestovanja u regrutovanju

- U civilnoj službi imaju pravo zapošljavanja ,državljani Republike Kosovapunoletnog uzrasta, koji imaju puno sprenosti za delovanje ,poseduju civilna i politicka prava ,imaju potrebnu obrazovnu spremu i profesionalnu sposobnost za vršenje izvršnih ,upravnih obaveza ili sprovodjenje administrativnih funksija i koji imaju fizicku sposobnost koja se zahteva za doticnu poziciju..

Procedure konkurisanja: otvorena za sve vanjske kandidate, kao i postojece civilne službenike...
Školska sprema, Sposobnosti,iskustvo i ostali drugi atributi koji se traže:

- Diploma srednje škole,
- Radno iskustvo (poželjno)
- Vrline komuniciranja ;
- Sposobnost za ispunjavanje zadataka I poslova pod presijom

Zakonski i podzakonski akti koji regulišu regrutovanje: Izabranje vrši se oslanjajuci se na Zakon o Radu Br03/L-212 i Administrativnog Uputstva Br. 07/2017 Regulisanje procedura konkursana javnom sektoru
Vremetrajanje imenovanja : neograniceno
Data zakljucenja konkursa; Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objevljivanja u sredstvima javnog informisanja 11.03.2019 do 29.03.2019 .
Podnošenje zahteva: Formulari apliciranja uzimaju se i dostave u skriptarnici-Prijemno odelenje prizemlje i na službenoj Web stranici opštine .
Aplikaciji treba priložiti ova dokumenta: Diplomu završene škole ili Overavano kopije Diplome,kopije lične karte,izvod-ekstrakt rodjenja,,dokaz da nije pod istragom..

"Civilna služba Kosova nudi ravnopravne mogučnosti zapošljavanja za sve gradjane Republike Kosova,i ocekuje aplikacije od svih lica muškog i ženskog roda svih zajednica Kosova"
"Zajednice manjine i njihovi pripadnici imaju pravo ravnopravnog i proporcijanog predstavljanja u organima civilne službe javne administracije lokalne i centralne ,kako se specificiraju u clanu 11 ,paragraf 3 Zakona Br..03/L-149 Civilne službe Republike Kosova"

Zahtevi dospeli posle istekanja roka nece si primiti.Nekompletirani dokazi mogu se odbijati..
Zbog velikog broja primljenih zahteva ,samo kandidati izabrani u tesnoj listi ,ce se kontaktirati.Za svaku informaciju kandidati mogu da kontaktiraju kancelariju personala..

Predsednik Opštine
Besim Ilazi

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

;

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Teuta Plakolli shpallë të pavlefshme ID-kartelën e Fakultetit të Arteve në AAB Vushtrri.

▶ Urgjentisht kërkoj një garsoniere me qera ne Fushë Kosovë për 1 person. Banesën e kërkoj për afatgjatë, ndërsa pagesën e kryej menjëherë për një vit. Për informata mund të më kontaktoni në këtë numër të telefonit: Tel 044 741 155

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi52 000€. Për info 044/672-439.

▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

▶ Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.]

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv.
Tel. 044-413-197, wiber: 045-198-095.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

▶ Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

▶ Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

▶ Shesim banesën dy dhomëshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit , çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387

▶ Lëshoj banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmi, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.

Në prag të 5, 6, 7 dhe 8 Marsit ditëve të lavdisë dhe sakrificës së familjes Jasharaj, ditës së mësuesit dhe ditës së nënës, për kandidat/etë interesuar për regjistrim të marrjes së patentë shoferit ofroj lehtësim financiar. **Vijimi i orëve praktike dhe teorike për 20 ore nga 200.00 Euro në 150.00 Euro.**

Interesimi i juaj - përkushtimi im. Eksperienca ime - suksesi i juaj. Afati i paraqitjes prej 01.03. 2019 deri më 10.03.2019.